



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT**  
*(Përfundimtar)*

**PËR**

**MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL**

**NJËSIA E QEVERISJES VENDORE**

**BASHKIA TROPOJË**

**Tiranë, Shkurt 2019**

## RAPORT

### **Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Tropojë**

#### **Hyrje**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në zbatim të planit vjetor të mbikëqyrjes dhe të Vendimit nr. 64, datë 07.06.2018, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në Bashkinë Tropojë”, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Tropojë.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të organizuara në bazë të ndarjes administrativo-territoriale të përcaktuar në ligjin nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”. Ndërsa, mënyra e funksionimit të njësive të vetëqeverisjes vendore, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre si dhe të organeve përkatëse janë të rregulluara me ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

Në nenin 5, të këtij ligji, përcaktohet se: “*Bashkia është njësi bazë e vetëqeverisjes vendore. Bashkia përfaqëson një unitet administrativo-territorial dhe bashkësi banorësh. Bashkitë, shtrirja territoriale, emri dhe qyteti qendër i saj, përcaktohen me ligj*”.

Më tej, në nenin 6 dhe 65, të këtij akti ligjor, përcaktohet se: “*Bashkia përbëhet nga disa njësi administrative, sipas lidhjeve tradicionale, historike, ekonomike dhe sociale. Njësitë administrative në territorin e një bashkie, shtrirja e tyre territoriale dhe emri, përcaktohen me ligj*”.

“*Struktura dhe organika e administratës së njësive administrative janë pjesë të strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë*”.

Në rastin konkret, Bashkia Tropojë, me qendër në Bajram Curri, përbëhet nga njësitë administrative Tropojë, Bujan, Bytyç, Margegaj, Llugaj, Fierzë dhe Lekbibaj, të përcaktuar në ligjin nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”. Struktura dhe organika e këtyre njësive administrative, janë pjesë përbërëse e strukturës dhe organikës së administratës së Bashkisë Tropojë dhe në këto rrethana kryerja e mbikëqyrjes është shtrirë dhe një njësitë administrative.

Në bazë të programit të mbikëqyrjes, nr. 506/1 prot., datë 07.06.2018, të miratuar nga Komisioneri dhe njoftuar institucionit me shkresën nr. 506/2 prot., datë 07.06.2018, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Bashkia Tropojë”, grupi i punës u paraqit në institucion në datën 12.06.2018.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha institutet e ligjit për nëpunësin civil, gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i punës, i përbërë nga inspektorët Ilir Sauli dhe Atalvin Niço, nën drejtimin e Drejtorit të Mbikëqyrjes, Altin Shumeli, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projektraportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Tropojë.

Ky material u dërgua për njohje në institucion me shkresën nr. 506/3 prot., datë 21.11.2018, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “*Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në Bashkinë Tropojë, në lidhje me administrimin e shërbimit civil*”, duke i lënë 15 ditë kohë, për të paraqitur observacionet në lidhje me gjetjet e grupit të punës.

Në vijim të këtij procesi, me shkresën nr. 2718/2 prot., datë 04.12.2018, institucioni ka dërguar të nënshkruar projektraportin së bashku me observacionin përkatës, i cili është analizuar në përmbajtjen e raportit përfundimtar.

Në këto rrethana, Komisioneri e vlerëson si të përmbushur detyrimin për të njohur subjektin me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes dhe çmon se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij, në lidhje me problematikën e evidentuar. Për këtë arsye, procesi i mbikëqyrjes do të vijojë me dërgimin e raportit përfundimtar dhe të vendimit paralajmërues për miratimin e tij, i cili përcakton edhe detyrat për të rregulluar situatën e konstatuar.

### **Qëllimi i mbikëqyrjes**

Qëllimi i realizimit të mbikëqyrjes është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.
- Paralajmërimin e institucionit dhe lënien e detyrave për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

### **Objekti i mbikëqyrjes**

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.
2. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:

- Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion.
  - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr. 8549, datë 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit Civil*”, apo për një periudhë jo më të vogël se 1 vit.
  - Nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese ose që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune.
  - Rastet e refuzimit të deklarimit të statusit të punësimit.
  - Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve.
  - Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.
3. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, që do të verifikohet në këto aspekte:
- Si është zbatuar procedura e hartimit të përshkrimit të punës dhe formati i miratuar me aktin nënligjor përkatës.
  - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 21, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.
  - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës.
4. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.
5. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.
6. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës (*detyrimet e nëpunësit dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe*).
7. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (*ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin, si dhe rastet e tjera të transferimit*).
8. Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj dhe si janë zbatuar kërkesat ligjore gjatë procedurës së zhvilluar në këto raste.
9. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore (*kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të Përhershëm*).
10. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar. Si materializohet

procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur aktorëve të këtij procesi gjatë vitit të vlerësimit (*Zyrtari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues*).

11. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimimit nga shërbimi civil: si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.
12. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (*njësisë përgjegjëse*), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

### **Metodologjia e mbikëqyrjes**

Grupi i mbikëqyrjes ka zgjedhur si metodë pune verifikimin e dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit, në arkivin e institucionit, si dhe në Sektorin e Burimeve Njerëzore, për çdo nëpunës të emëruar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, u ndërmorën veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u realizua një takim me Zv/Kryetarin e Bashkisë Tropojë, \*\*\*\*\* dhe me Përgjegjës të Sektorit të Burimeve Njerëzore \*\*\*\*\*, gjatë të cilit u diskutua mbi objektin dhe drejtimit të mbikëqyrjes, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkrues që duhet të vihet në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes për verifikim.
- Nëpunësi \*\*\*\*\*, me detyrë “*Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore*”, u caktua si person kontakti për grupin e punës.
- U verifikuan pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës, për Bashkinë Tropojë, si dhe për Njësitë Administrative që janë pjesë përbërëse e saj.
- U verifikuan procedurat e rekrutimit dhe përmbajtja e dosjeve individuale të çdo nëpunësi civil, si dhe çdo e dhënë tjetër e kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil.
- U verifikuan të dhënat profesionale, si dhe të dhënat e tjera për marrëdhëniet e punës të çdo nëpunësi civil, lidhur me përmbushjen e kërkesave të posaçme të pozicionit të punës si niveli arsimor, përvoja në punë, e tjera.
- U administrua dokumentacioni i kërkuar, ku përfshihen listë prezencat dhe listë pagesa e punonjësve për periudhën Shkurt 2014 dhe për periudhën Maj 2018.
- U verifikua ligjshmëria e gjithë akteve të deklarimit të statusit të nëpunësit civil lëshuar nga njësia e personelit, për të gjithë nëpunësit e bashkisë.

Konstatimet janë të materializuara si tabela më vete (*Tabela 1, dhe Tabela 2*), të cilat janë pjesë e këtij raporti.

## Përmbajtja e raportit:

- I. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.

1. Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes.

Bashkia Tropojë, si organ i vetëqeverisjes vendore, ka hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr. 8549/1999, "Statusi i nëpunësit civil", (i shfuqizuar) dhe ka ruajtur të njëjtin status edhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, pasi, në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Administrimi i shërbimit civil në këtë institucion, përpara reformës territoriale, është bërë mbi bazën e strukturave organizative të miratuara nga Këshilli Bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", (i shfuqizuar), i cili, në nenin 32, shkronja "ç", përcaktonte se, struktura dhe organika e administratës së bashkisë, miratohet nga Këshilli Bashkiak.

Pas riorganizimit të organeve të qeverisjes vendore, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", këto kompetenca kanë ndryshuar.

Në rastin konkret, në nenin 54, të ligjit, ku parashikohen detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak, në shkronjën "dh", përcaktohet se, këshilli bashkiak, miraton buxhetin si dhe numrin maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësisve e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë.

Ndërsa në nenin 64, të këtij akti ligjor, ku parashikohen detyrat dhe kompetencat e kryetarit të bashkisë, në shkronjën "j", përcaktohet se, kryetari i bashkisë, miraton strukturën, organikën e kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njësisve e institucioneve në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Nisur nga këto përcaktime ligjore, nga analiza e dokumentacionit që u vu në dispozicion, konstatohet se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, (datë 26.02.2014), Bashkia Tropojë, ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 10, datë 10.02.2014, të Këshillit Bashkiak, "Mbi miratimin e strukturës, organikës dhe numrin e punonjësve të administratës së Bashkisë Bajram Curri". Bazuar në këtë strukturë organizative, rezulton se administrata e bashkisë në këtë periudhë ka gjithsej **83** pozicione pune, nga të cilat **23** pozicione pune vlerësohen si pjesë e shërbimit civil.

Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, rezulton se me vendimin nr. 31, datë 20.06.2014, të Këshillit Bashkiak, “Për disa ndryshime në VKB nr. 10, datë 10.02.2014, “Mbi miratimin e strukturës, organikës dhe numrin e punonjësve të administratës së Bashkisë Bajram Curri”, është miratuar struktura e re e institucionit të Bashkisë Bajram Curri.

Për shkak të riorganizimit territorial, bazuar në ligjin nr. 30/2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar”, (i shfuqizuar), rezulton se Kryetari i Bashkisë ka miratuar strukturën e Bashkisë Tropojë dhe të njëjsteve administrative, pjesë përbërëse e saj.

Në momentin e realizimit të mbikëqyrjes, institucioni i Bashkisë Tropojë, funksionin në bazë të strukturës së miratuar me urdhrin nr. 55, datë 28.03.2018, të Kryetarit të Bashkisë, “Për një ndryshim në strukturën organike të Bashkisë Tropojë për vitin 2018”. Bazuar në këtë strukturë organizative, rezulton se institucioni i mbikëqyrur ka gjithsej **326** pozicione pune, nga të cilat:

- Administrata e bashkisë ka gjithsej **134** pozicione pune, nga të cilat vlerësohen si pjesë e shërbimit civil **40** pozicione;
- Funksione të deleguara pranë aparatit të bashkisë, janë gjithsej **145** pozicione pune, nga të cilat vlerësohen si pjesë e shërbimit civil **8** pozicione pune;
- Njësitë administrative kanë gjithsej **46** pozicione pune, nga të cilat vlerësohen si pjesë e shërbimit civil **11** pozicione pune.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar me Vendimin nr. 262, datë 25.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, **59** pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në **administratën e Bashkisë Tropojë, së bashku me njësitë administrative**, paraqiten në këtë raport:

- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues, janë **4** pozicione pune, ose **8 %** e pozicione të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor Drejtorie”;
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues, janë **11** pozicione pune, ose **21 %** e pozicione të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit “Përgjegjës Sektori”;
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **44** pozicione pune, ose **71 %** e pozicione të punës pjesë e shërbimit civil, ku **27** prej tyre janë pjesë e aparatit të bashkisë, **6** janë funksione të deleguara dhe **11** janë pjesë e njëjsteve administrative.  
Nga mënyra e emërtesës, konstatohet se, **27** pozicione pune i përkasin pozicionit “Specialist”, **5** pozicione i përkasin pozicionin “Inspektor” dhe **12** pozicione pune janë pa emërtesën “Specialist/Inspektor”.

## 2. Struktura dhe organika aktuale e Bashkisë Tropojë

Nga këqyrja e strukturës dhe organikës së Bashkisë Tropojë dhe njërive administrative pjesë përbërëse e saj, miratuar me urdhrin 55, datë 28.03.2018, të Kryetarit të Bashkisë, “Për një ndryshim në strukturën organike të Bashkisë Tropojë për vitin 2018”, konstatohen disa parregullsi, të cilat kanë të bëjnë me mënyrën e ndërtimit të strukturës si dhe emërtesën e pozicioneve pjesë e shërbimit civil, të cilat po i analizojmë më poshtë, në mënyrë të detajuar:

**Së pari**, konstatohet se, struktura dhe organika e institucionit nuk ka parashikuar pozicion të shërbimit civil të nivelit të lartë drejtues, siç është pozicioni i sekretarit të përgjithshëm/drejtor departamenti/drejtor drejtorie të përgjithshme apo një pozicion të barasvlershëm me këto tre pozicione.

Në kuptim të Lidhjes nr. 2, klasa I/2, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, Sekretari i Përgjithshëm në njësitë e qeverisjes vendore, në rastin konkret në bashki, ka rolin e nëpunësit më të lartë civil të institucionit.

Ekzistenca e pozicionit të “Sekretarit të Përgjithshëm”, në strukturën organizative të një institucioni lehtëson zbatimin e disa skemave të administrimit të shërbimit civil siç janë:

- **Ecuria disiplinore**: Në rastin kur ndaj një nëpunësi civil fillon procedimi disiplinor për shkelje të rënda ose shumë të rënda, në kuptim të nenit 59, pika 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Kreut I, pika 3, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, Sekretari i Përgjithshëm, përcaktohet shprehimisht si një nga anëtarët e Komisionit Disiplinor, në cilësinë e nëpunësit më të lartë civil të njësisë së qeverisjes vendore, bashki.
- **Përshkrimet e punës**: Miratimi i përshkrimeve të punës, i parashikuar në pikën 18, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar. Në shkronjën “ç”, të kësaj pike, përcaktohet se, “përshkrimet e punës miratohen nga sekretari i përgjithshëm apo pozicioni ekuivalent me të”.

**Së dyti**, disa pozicione të nivelit ekzekutiv, të kategorisë ekzekutive, të cilat janë pjesë e organikës së bashkisë, nuk janë me emërtesën “Specialist”ose “Inspektor”, dhe si rrjedhim nuk trajtohen si pozicione të cilat përfshihen në skemën e shërbimit civil. Në rastin konkret bëhet fjalë për pozicionet:

1. Administrator i ndihmës ekonomike – 2 pozicione;
2. Punonjës social për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve – 1 pozicion;
3. Punonjës i arkivit dhe protokollit – 1 pozicion;



Në lidhje me këto pozicione pune, vërehet se, ato janë pjesë e organikës së miratuar për aparatën e bashkisë, të cilat janë vendosur në sektorë dhe drejtori, dhe raportojnë sipas shkallës së hierarkisë tek personat përkatës. Për këto pozicione pune konstatohet, se detyrat dhe funksionet e tyre janë të përcaktuara në përshkrimet e punës, si dhe në Rregulloren “*Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Bashkisë Tropojë*”, miratuar me urdhrin nr. 41, datë 06.03.2018, të Kryetarit të Bashkisë.

Komisioneri, kërkon të sjellë në vëmendje të njësive të burimeve njerëzore të Bashkisë Tropojë se, në vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, i Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, në Kreun III, pika 9, shkronja “a” dhe “b”, dhe pika 12, përcaktohet se:

Pika 9) “*Pozicionet e shërbimit civil të kategorisë ekzekutive klasifikohen sipas natyrës së pozicionit në:*

- a) *grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm dhe;*
- b) *grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm.*

10. ... .

11. ... .

12. *Grupet e pozicioneve të administrimit të posaçëm përcaktohen në lidhjen 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi”.*

Më tej, lidhja nr. 3 “*Klasifikimi i pozicioneve të punës sipas grupeve të ngjashme të punës/sipas profesioneve të punës*”, ka renditur pozicionet e shërbimit civil sipas grupeve të ngjashme të punës dhe sipas profesioneve, dukë përcaktuar dhe përshkrimin e përgjithshëm të punëve për çdo grup të pozicioneve të administrimit të posaçëm. (Kjo lidhje është ndërtuar me 6 kolona). Konkretisht:

- ***Në ndarjen me numër rendor 34***, në kolonën e dytë, përmendet në mënyrë të shprehur emërtesa e grupit të punës “*Specialistë të përkujdesjes shoqërore, përfshirjes sociale dhe të shërbimeve sociale*”. Referuar përcaktimeve të kolonës tre “*Përshkrimi i përgjithshëm i punëve të grupit*”, njësia përgjegjëse duhet të përfshijë në shërbimin civil pozicionet “*Administrator i Ndhmës Ekonomike*” dhe “*Punonjës social për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve*”;
- ***Në ndarjen me numër rendor 26***, në kolonën e dytë, përmendet në mënyrë të shprehur emërtesa e grupit të punës “*Specialistë të arkivave*”. Referuar kolonës tre “*Përshkrimi i përgjithshëm i punëve të grupit*”, njësia përgjegjëse duhet të përfshijë në shërbimin civil pozicionin “*Punonjës i arkivit dhe protokollit*”.

**Së treti**, konstatohet se, **7** pozicione pune me emërtesë: “*Punonjës i ndihmës ekonomike*”, **1** pozicion pune; “*Specialist i bujqësisë dhe shërbimeve*”, **1** pozicion pune; “*Inspektor i shërbimit pyjor dhe sekretar/arkivit*” dhe “*Inspektor i shërbimit të pyjeve dhe kullotave*”, të cilat janë pjesë e strukturës së njësive administrative, nuk janë përfshirë në skemën e shërbimit civil. Referuar Lidhjes nr. 3, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, i Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, pozicionet e mësipërme, nisur nga emërtesa e grupit të punës dhe

përshkrimit të përgjithshëm të grupit të punës, përfshihen në fushën e veprimit të ligjit të shërbimit civil, për sa më poshtë:

- **Në ndarjen me numër rendor 8**, në kolonën e dytë, përmendet në mënyrë të shprehur emërtesa e grupit të punës “*Specialistë/inspektorë të prodhimit bimor, të mbrojtjes së bimëve dhe të tjera të lidhura me to*”. Referuar kolonës tre, “*Përshkrimi i përgjithshëm i punëve të grupit*”, njësia përgjegjëse duhet të përfshijë në shërbimin civil pozicionin, që në strukturën aktuale mban emërtesën “*Specialist i bujqësisë dhe shërbimeve*”, “*Inspektor i shërbimit pyjor dhe sekretar/arkivit*” dhe “*Inspektor i shërbimit të pyjeve dhe kullotave*”;
- **Në ndarjen me numër rendor 26**, në kolonën e dytë, përmendet në mënyrë të shprehur emërtesa e grupit të punës “*Specialistë të arkivave*”. Referuar kolonës tre “*Përshkrimi i përgjithshëm i punëve të grupit*”, njësia përgjegjëse duhet të përfshijë në shërbimin civil pozicionin, që në strukturën aktuale mban emërtesën “*Specialist i bujqësisë dhe shërbimeve*”.
- **Në ndarjen me numër rendor 34**, në kolonën e dytë, përmendet në mënyrë të shprehur emërtesa e grupit të punës “*Specialistë të përkujdesjes shoqërore, përfshirjes sociale dhe të shërbimeve sociale*”. Referuar përcaktimeve të kolonës tre “*Përshkrimi i përgjithshëm i punëve të grupit*”, njësia përgjegjëse duhet të përfshijë në shërbimin civil pozicionet me emërtesën “*Punonjës i ndihmës ekonomike*”.

Për sa më sipër, pozicionet e mësipërme, duhet të konsiderohen si pozicione të shërbimit civil, por nisur nga fakti që këto pozicione janë pjesë e strukturës dhe organikës së njësie administrative, njësia përgjegjëse e këtij institucioni, fillimisht duhet të përcaktojë qartë detyrat teknike dhe përgjegjësitë ligjore, që realizon çdo pozicion pune dhe më pas, të përcaktojë nëse këto pozicione do t’i nënshtrohen skemës së shërbimit civil.

**Së katërti**, konstatohet se në strukturën e Bashkisë Tropojë përfshihet Drejtorja e Shërbimit Pyjor, e cila përbën një funksion të deleguar pranë këtij institucioni. Në përbërje të kësaj njësie organizative paraqiten pozicionet me emërtesën “*Drejtor*”, “*Përgjegjës Sektori*” dhe **6** pozicione me emërtesën “*Inxhinier pyjesh*”.

Sjellim në vëmendje të njësisë përgjegjëse se, organizimi dhe funksionimi i administratës së Shërbimit Pyjor rregullohet me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005, “*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*”, i ndryshuar. Në nenin 6 të këtij ligji përcaktohet shprehimisht se shërbimi pyjor ka dy funksione, konkretisht **a) funksionin menaxhues** dhe **b) funksionin kontrollues**, ku ky i fundit ushtrohet nga Policia Pyjore, në përputhje me ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011, “*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*”.

Sipas nenit 7, pika 3/1, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*”, i ndryshuar, njësitë e qeverisjes vendore, në rastin konkret bashkitë, në kuadër të shërbimit pyjor kanë të drejtën e ngritjes së strukturave përkatëse për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor dhe kullësor brenda kufijve territorialë administrativë, me **personel inxhiniero-teknik me arsim pyjor**. Më tej, në nenin 11, pika 1, të ligjit në fjalë përcaktohet se: “*Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki është organi i specializuar i këtij shërbimi në nivel vendor, me attribute teknike, menaxhuese e këshillimore, në përbërje të bashkisë*”.

Rezultoni se, detyrat dhe funksionet për pozicionet e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, janë përcaktuar në Rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e administratës së Bashkisë Tropojë”, miratuar me urdhrin nr. 41, datë 06.03.2018, të Kryetarit të Bashkisë. Nga analiza e përgjegjësive dhe detyrave përkatëse për pozicionet e punës, pjesë e kësaj drejtorie, rezultoni se ato kanë funksione menaxhuese.

Njëkohësisht, në lidhjen nr. 3, të vendimit nr. 142 datë 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, **në ndarjen me numër rendor 8**, në kolonën e tretë, përcaktohet se, pozicionet e punës, të cilat kanë si përshkrim pune hartimin, zbatimin e politikave të mbarështimit pyjor, ruajtjen, zhvillimin e fondit pyjor kombëtar, sigurimin e kushteve për përdorimin dhe shfrytëzimin, zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor kombëtar, ruajtjen dhe krijimin e kushteve natyrore...., përfshihen në skemën e shërbimit civil.

Nga ana tjetër, në referencë të strukturës aktuale të Bashkisë Tropojë, konstatohet se, në përbërje të kësaj njësie organizative, janë parashikuar dhe **4** pozicione me emërtesën “Roje pylli”, të cilët angazhohen në terren, në funksion të mbrojtjes së pyllit nga prerjet e paligjshme, prishjet e paligjshme dhe nga zjarre të mundshme, e si rrjedhim këto pozicione nuk përfshihen në skemën e shërbimit civil.

Në këto kushte, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tropojë, duhet të përfshijë në shërbimin civil, pozicionet që në strukturën aktuale të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, mbajnë emërtesën “Drejtör”, “Përgjegjës Sektori” dhe “Inxhinier pyjesh”.

Bazuar në faktet e përmendura më sipër dhe në analizën e akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë organizimin e shërbimit civil, në strukturën pasardhëse të institucionit të përcaktohen qartë pozicionet e shërbimit civil, në përmbajtjen e saj, duke i ndarë ato nga pozicionet që do të kryejnë funksione politike dhe nga pozicionet që nuk ushtrojnë funksion publik (*punonjësit administrativë*).

Sjellim në vëmendje se, në përgatitjet e strukturës organizative pasardhëse, për aparatën e institucionit duhet të zbatohen edhe standardet e përcaktuara në këtë drejtim, në vendimin nr. 893, dt. 17.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”.

Në pikën 5 të këtij vendimi është parashikuar se:

*“Strukturat organizative për kryerjen e funksioneve administrative në institucionet e administratës shtetërore veçojnë në përmbajtjen e tyre tri nivele:*

- *Funksionarë politikë;*
- *Nëpunës civilë;*
- *Punonjës administrativë”.*

Në zbatim të kësaj dispozite, pozicionet e punës që përfshihen në shërbimin civil duhet të jenë të evidentuara në mënyrë të qartë që në përmbajtjen e strukturës dhe organikës së institucionit.

Për këtë arsye, njësia e burimeve njerëzore, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit, përgatit për Kryetarin e Bashkisë propozimin për strukturën dhe organikën e re dhe në përmbajtjen e relacionit që duhet të hartohet në këtë rast, duhet të arsyetohet në mënyrë të hollësishme mënyra e organizimit të njësive organizative, siç janë drejtoritë dhe sektorët, detyrat dhe përgjegjësitë që ato kanë, pozicionimi në strukturë, natyra e punës së çdo pozicioni, lloji i detyrave që ai realizon, si dhe niveli arsimor i nevojshëm për kryerjen e detyrave, pra të materializohet një analizë funksionale e institucionit.

Njësia përgjegjëse duhet të vlerësojë për secilin pozicion pune, nëse ai realizon funksione apo detyra në përputhje me përcaktimet e shkronjës “c”, të nenit 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ku parashikohet se:

*“Nëpunës civil” është personi që kryen funksionin për ushtrimin e autoritetit administrativ, publik, në bazë të aftësisë dhe profesionalizmit, i cili merr pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre”.*

Në një rast të tillë, pozicionet e punës do të konsiderohen pjesë e shërbimit civil, e për këtë arsye, edhe emërtesat e tyre do të jenë sipas ligjit për nëpunësin civil. Më tej, plotësimi i pozicioneve të punës do të bëhet në përputhje me procedurat e konkurrimit të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

### **Konstatim**

Në përmbajtjen e shkresës nr. 2718/2 prot., datë 04.12.2018, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, “Observacione mbi projektraportin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dërguar me shkresën nr. 506/3 prot., datë 21.11.2018”, janë parashtruar disa pretendime lidhur me raportin e disa pozicioneve të punës me shërbimin civil, të cilat Komisioneri pasi i analizoi me vëmendje, vlerëson se ato nuk qëndrojnë, për arsyet e parashtruara në vijim.

- a- Pretendimi i njësisë përgjegjëse, se pozicionet me emërtesën “Administrator i Ndhmës Ekonomike”, “Administrator për paaftësinë dhe invaliditetin” dhe “Punonjës social për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe grave të dhunuara”, janë trajtuar si pozicione të shërbimit civil, pavarësisht emërtesës në strukturë.

Në analizë të strukturës organizative të Bashkisë Tropojë, Komisioneri konstaton se, pozicionet e punës “Administrator i Ndhmës Ekonomike” dhe “Administrator për paaftësinë dhe invaliditetin”, nuk janë emërtuar sipas kërkesave të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Njëkohësisht, konstatohet se, sipas strukturës aktuale të institucionit, pozicioni i punës “Punonjës social për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe grave të dhunuara”, jo vetëm që nuk shoqërohet me emërtesën “Specialist”, por nga ana tjetër, rezulton të mos jetë i klasifikuar si pozicion i shërbimit civil. (Fakt që materializohet në strukturën

*organike të Bashkisë Tropojë, ku në numrin rendor 24, në kolonën “Statusi”, për këtë pozicion pune është bërë klasifikimi “Kod Pune”).*

Në këto kushte, i lihet detyrë njësisë përgjegjëse, që me miratimin e strukturës organike të bashkisë Tropojë për vitin 2019, të saktësojë emërtesat e pozicioneve të mësipërme të punës, në përputhje me kërkesat e nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë aspekt të ligjit.

- b- Pretendimi i njësisë përgjegjëse se, pozicionet e punës “*Punonjës i ndihmës ekonomike*”, në njësitë administrative të Bashkisë Tropojë nuk klasifikohen si pjesë e shërbimit civil, pasi ushtrojnë funksione shërbimi ndaj familjeve në nevojë, nuk qëndron, pasi ky argument nuk mbështetet nga përmbajtja e ligjeve funksionale që veprojnë në fushën ku kryejnë veprimtarinë e tyre këto pozicione pune.

Në referencë të nenit 29, 30, 30/1 dhe 31, të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, rezulton se, për administrimin e skemës së ndihmës dhe shërbimeve shoqërore, pranë bashkive ngrihen struktura përkatëse. Duke vijuar më tej, rezulton se, në nenin 31, të po këtij ligji përcaktohet se, administratori shoqëror në bashki ose komuna (*sot njësi administrative, pjesë përbërë e bashkisë*), është përgjegjës për grumbullimin dhe hartimin e informacioneve, statistikave; vlerësimin e nevojave të individëve ose familjeve; hartimin e planeve vendore dhe rajonale në mbështetje të personave në nevojë; kontribuimin në procesin e hartimit të projektvendimit për propozimin e familjeve në nevojë; etj. Në këto akte ligjore, fusha e veprimit në këtë rast është shumë më e gjerë se ajo që është cituar në observacionet e paraqitura nga subjekti dhe pozicionet e punës që realizojnë këto kompetenca, rezultojnë së janë me tipare të shërbimit civil.

Pozicionet e punës, të cilat janë pjesë e shërbimit civil, nuk kanë vetëm rol vendimmarrës ashtu si pretendohet në observacione, por ato ushtrojnë autoritet administrativ, publik që ka të bëjë me formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative, etj, ashtu si përkufizohet nocioni i nëpunësit civil, në nenin 4, të ligjit për nëpunësin civil. Për më tepër, këto pozicione specifikohen si pjesë e shërbimit civil, edhe në udhëzimin e Departamentit të Administratës Publike, në lidhje me përshkrimet e pozicioneve të punës në shërbimin civil.

- c- Pretendimi i njësisë përgjegjëse se, pozicionet në strukturën e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, nuk janë përfshirë në skemën e shërbimit civil, pasi kjo njësi është konsideruar si njësi shërbimi, nuk qëndron, pasi vjen në kundërshtim me legjislacionin specifik që rregullon veprimtarinë dhe kompetencat e kësaj njësie organizative.

Konkretisht, në nenet 6, 7, 9 dhe 11, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, përcaktohen qartësisht **a**) mënyra e organizimit të strukturave përgjegjëse për shërbimin pyjor pranë njësisve e qeverisjes vendore (bashki) si dhe **b**) detyrat që ato kryejnë në kuadër të ushtrimit të kompetencave ligjore. Duke analizuar detyrat e përcaktuara në pikën 2, të nenit 11, të po këtij ligji, rezulton se struktura e shërbimit pyjor pranë bashkive, nuk i përgjigjet modelit njësi shërbimi, sipas përcaktimeve të pikës “*dh*”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Nga renditja e detyrave të përcaktuara në ligjin specifik të shërbimit pyjor,

rezulton se kjo strukturë përbën një organ të specializuar me attribute jo vetëm teknike, por dhe menaxhuese dhe këshillimore, të cilat janë attribute që i përkasin pozicioneve të shërbimit civil.

Në vijim, Komisioneri vlerëson se, në Lidhjen nr. 3, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, konkretisht në nënndarjen me numër rendor 8, nuk ka asnjë paqartësi apo boshllëk ligjor, nëse pozicionet e strukturës së shërbimit pyjor janë apo jo pozicione të shërbimit civil. Në këtë nënndarje, përcaktohet se, janë pozicione të shërbimit civil, ato pozicione të cilat janë përgjegjëse për mbrojtjen, administrimin, ruajtjen dhe zhvillimin e fondit pyjor dhe se punonjësit e emëruar në këto pozicione mund të jenë agronom ose këshillues për ferma dhe pyje, sipas nën ndarjeve që përmban ky nëngrup dhe në përputhje me Listën Kombëtare të Profesioneve.

Sa më sipër, për të gjitha këto raste, i lihet detyrë njësisë përgjegjëse që të saktësojë emërtesat e pozicioneve të punës, të përcaktojë qartë detyrat teknike dhe përgjegjësitë ligjore që realizon secili pozicion pune dhe gjatë zhvillimit të procedurave për përgatitjen dhe propozimin e strukturës së re organizative, ato të trajtohen si pozicione të shërbimit civil.

**Konkluzion:** Në këto kushte, Komisioneri arrin në konkluzionin se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tropojë, me qëllim krijimin e një strukturë të qëndrueshme, që të mos ketë nevojë për ndryshime, në momentin e miratimit të strukturës së ardhshme, duhet të veprojë si më poshtë:

1. Të zbatojë parimin bazë të ndërtimit të strukturës, që është përcaktimi i hierarkisë administrative, duke evidentuar në strukturën organizative të bashkisë pozicionin e “Sekretarit të Përgjithshëm”, ose një pozicion të barasvlershëm me të, duke u orientuar në përcaktimet e ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.
2. Për pozicionet e punës me emërtesën “Administrator i ndihmës ekonomike”, “Administrator për paaftësinë dhe invaliditetin”, “Punonjës social për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve” dhe “Punonjës i arkivit dhe protokollit”, pjesë e organikës së administratës së bashkisë, njësia përgjegjëse të saktësojë emërtesat sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
3. Pozicionet me emërtesën “Punonjës i ndihmës ekonomike”, “Specialist i bujqësisë dhe shërbimeve”, “Inspektor i shërbimit pyjor dhe sekretar/arkivit” dhe “Inspektor i shërbimit të pyjeve dhe kullotave”, pjesë e organikës së njësisë administrative, duhet të përcaktojë qartësisht detyrat teknike dhe përgjegjësitë që realizon secili pozicion pune dhe më pas, të përcaktojë nëse këto pozicione përfshihen në skemën e shërbimit civil.
4. Për pozicionet e punës, pjesë përbërëse e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, duhet të marrë masa për t’i përfshirë në shërbimin civil, duke përcaktuar qartësisht detyrat dhe funksionet e tyre, si dhe t’i plotësojë këto pozicione me punonjës, në përputhje me

procedurën e përcaktuar në nenet 22, 23, 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

5. Ndryshimet e mësipërme, duhet të evidentohen në rregulloren e brendshme, e cila aktualisht në përmbajtje të saj, nuk përcakton qartësisht se për cilat pozicione pune marrëdhënia e punësimit rregullohet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

### 3. Mënyra e plotësimit të pozicioneve të shërbimit civil në momentin e realizimit të mbikëqyrjes

Nga kontrolli i ushtruar, si dhe nga materialet që janë vënë në dispozicion nga njësia e burimeve njerëzore, mënyra e plotësimit të **59** pozicioneve të punës në institucionin e Bashkisë Tropojë, që janë pjesë e shërbimit civil në momentin e realizimit të mbikëqyrjes dhe pjesa që zënë në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës, pjesë e shërbimit civil, paraqitet si më poshtë:

- **13 pozicione pune**, që zënë rreth **21%** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, janë plotësuar me nëpunës të emëruar përpara fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të cilat ndahen si më poshtë:
  - Në **12** raste, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit, nga të cilët:
    - Në **10** raste, deklarimi i statusit të punësimit si “Nëpunës civil”, është kryer në përputhje me kërkesat e nenit 67, pika 3, të këtij ligji;
    - në **1** rast, deklarimi i statusit të punësimit si “Nëpunës Civil në Periudhë Prove”, është kryer në përputhje me kërkesat e nenit 67, pika 4, të këtij ligji;
    - në **1** rast, deklarimi i statusit të punësimit si “Nëpunës civil”, është kryer në kundërshtim me nenin 67, pika 4, pasi nëpunësi duhet të ishte deklaruar “Nëpunës civil në periudhë prove”. (Bëhet fjalë për nëpunësen \*\*\*\*\* e cila ka qenë e punësuar me urdhrin nr. 1, datë 06.12.2013, në pozicionin e punës “Kontabiliste”, në ish Komunën Bujan);
  - në **1** rast, njësia përgjegjëse nuk ka procedura me deklaramin e statusit të punësimit, ndërkohë që konstatohet se periudha e punësimit ka qenë më tepër se një vit, por punonjësi nuk i plotëson kriteret për të qenë nëpunës civil. (Bëhet fjalë për punonjësin \*\*\*\*\*);
- **18 pozicione pune**, që zënë rreth **32%** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, janë plotësuar me nëpunës të emëruar me akte emërimi të përkohshëm pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- **22 pozicione pune**, që zënë rreth **36 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, janë plotësuar me nëpunës të emëruar me procedurë të rregullt konkurrimi;

- 6 pozicione pune, që zënë rreth **10%** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, janë vende të lira. Këto i përkasin pozicioneve të punës “Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor”, “Specialist për administrimin e regjimit të territorit”, “Specialist për prokurimet publike” dhe 3 pozicione “Inxhinier pyjesh”, në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor”.
4. **Plotësimi i kushteve ligjore për të përfutuar statusin e nëpunësit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.**

Një aspekt i rëndësishëm i procesit të mbikëqyrjes është përcaktuar verifikimi i plotësimit të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, të cilët kanë qenë në marrëdhënie pune në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil.

Nisur nga fakti që institucioni i mbikëqyrur është pjesë e shërbimit civil, atëherë deklarimi si nëpunës civilë ekzistues për çdo punonjës të këtij institucioni, duhet të bëhet në respektim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, neni 67, pikat 3, 4 dhe 6, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur kohëzgjatja e marrëdhënies së punës, nga momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, për të përcaktuar kategorinë si nëpunës civil (më shumë se 1 vit), apo nëpunës civil në periudhë prove (më pak se një vit), si dhe organi që realizon deklarin e statusit të punësimit (njësia përgjegjëse).

Ky proces rregullohet në mënyrë të hollësishme edhe me Vendimin nr. 116, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, Kreu III, “Statusi i punonjësve ekzistues në institucionet e administratës shtetërore dhe komutat”, pika 1 dhe 2, të ndryshuar.

Dispozitat e sipërpërmendura, përbëjnë kuadrin ligjor të zbatueshëm për deklarin e statusit të punësimit, pas verifikimit të procedurës së punësimit për gjithë nëpunësit që mbanin pozicione pune të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Mbështetur në këtë bazë ligjore, për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga njësia e burimeve njerëzore, si njësi përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, nëse veprimet e saj janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit për deklarin e statusit të punësimit, u verifikuan dhe analizuan të gjitha materialet shkresore, që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, siç mund të përmendim:

- ✓ Organigramën dhe strukturën e institucionit, e cila ka qenë në fuqi në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, si dhe listë pagesën dhe listë prezencën e muajit Shkurt 2014;
- ✓ Dokumentacionin e plotë që vërteton procedurën e marrjes në punë, përfshirë aktin e emërimit apo kontratën e punësimit;



- ✓ Librezën e punës, si dokumente që vërtetojnë fillimin e marrëdhënies financiare, hyrjen në punë dhe kohëzgjatjen e punësimit;
- ✓ Të dhënat profesionale dhe çdo të dhënë tjetër lidhur me marrëdhënien e punës në shërbimin civil.

Pas analizës së situatës, lidhur me statusin e punësimit të punonjësve të këtij institucioni, bazuar në strukturën analitike që ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të mbikëqyrjes, më poshtë po paraqesim gjendjen, sipas aspekteve të ndryshme të trajtuara në këtë rast dhe problematikave të hasura.

**4.1 Punonjës të cilët janë emëruar para momentit të fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të cilët aktualisht ushtrojnë detyrën në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil.**

Nga analiza e materiale të verifikuara, rezulton se, në 13 raste, në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në këtë institucion, janë emëruar punonjës me akte emërimi të përkohshëm apo me kontratë pune, duke mos respektuar procedurat e konkurrimit, sikurse përcaktohej në nenin 13, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”, tashmë i shfuqizuar.

Megjithëse kjo dispozitë ligjore përcaktonte konkurrimin, si të vetmen mënyrë të rekrutimit në shërbimin civil, marrëdhëniet e punës për këta punonjës, kanë vazhduar të rregullohen sipas Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.

Në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit për këtë kategori punonjësish, mbështetur në përmbajtje të pikës 3 dhe 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe nisur nga momenti i emërimit, që del nga procesi i këqyrjes së akteve të emërimit si dhe verifikimit të librezës së punës, listë prezencës dhe listë pagesës së muajit Shkurt 2014, konstatohet se:

- **10 pozicione të shërbimit civil, janë plotësuar nga nëpunës civilë ekzistues, për të cilët është deklaruar statusi i punësimit “Nëpunës civil”**

Duke u nisur nga analiza që i është bërë akteve të emërimit, ku përfshihet momenti i fillimit të marrëdhënies të punës dhe atyre financiare, rezulton se, këta punonjës, kanë më shumë se një vit, nga momenti që kanë filluar efektet juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, që e kryejnë detyrën e tyre funksionale në pozicione pune pjesë të shërbimit civil. Bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

1. \*\*\*\*\*\*, emëruar me vendimin nr. 5, datë 30.03.2007, në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Buxhetit*”, në Bashkinë Tropojë. Me aktin nr. 17, datë 10.06.2014, është deklaruar “*Nëpunës civil*”, në pozicionin e mësipërm.
2. \*\*\*\*\*\*, emëruar me urdhrin nr. 19, datë 10.10.1997, në pozicionin “*Ekonomiste tatim-taksave*”, në Bashkinë Tropojë. Me aktin nr. 711/18, datë 10.06.2014, është deklaruar “*Nëpunës civil*”, në pozicionin “*Administrator i ndihmës ekonomike*”.

3. \*\*\*\*\*, ishte i punësuar në pozicionin “Përgjegjës Zyre”, në Bashkinë Tropojë (mungon akti i emërimit, por sipas librezës së punës marrëdhëniet financiare kanë filluar në datën 11.01.2009). Me aktin nr. 217, datë 23.04.2014, është deklaruar “Nëpunës civil”, në pozicionin e mësipërm.
4. \*\*\*\*\*, ishte e punësuar në pozicionin “Inspektor Urbanistike”, në Bashkinë Tropojë (mungon akti i emërimit, por sipas librezës së punës marrëdhëniet financiare kanë filluar në datën 12.04.2007). Me aktin nr. 711/6, datë 10.06.2014, është deklaruar “Nëpunës civil”, në pozicionin e mësipërm.
5. \*\*\*\*\*, emëruar me kontratën e datës 03.01.2013, në pozicionin “Përgjegjës Zyre”, në ish Komunën Bujan (sot njësi administrative). Me aktin nr. 113, datë 29.04.2015, është deklaruar “Nëpunës civil”, në pozicionin e mësipërm.
6. \*\*\*\*\*, emëruar me aktin nr. 18, datë 25.06.2007, në pozicionin “Inspektor i shërbimeve publike dhe mjedisit”, në Bashkinë Tropojë. Me aktin nr. 26, datë 10.06.2014, është deklaruar “Nëpunës civil”, në pozicionin e mësipërm.
7. \*\*\*\*\*, ka qenë i emëruar në pozicionin “Përgjegjës Zyre”, në ish Komunën Fierzë, sot njësi administrative (mungon akti i emërimit, por sipas librezës së punës marrëdhëniet financiare kanë filluar në datën 01.08.2007). Me aktin nr. 219, datë 23.04.2015, është deklaruar “Nëpunës civil”, në pozicionin e mësipërm.
8. \*\*\*\*\*, ka qenë i emëruar në pozicionin “Veteriner”, në ish Komunën Tropojë, sot njësi administrative (mungon akti i emërimit, por sipas librezës së punës marrëdhëniet financiare kanë filluar në datën 01.05.2006). Me aktin nr. 825, datë 13.04.2015, është deklaruar “Nëpunës civil”, në pozicionin e mësipërm.
9. \*\*\*\*\*, ka qenë e emëruar në pozicionin “Specialist i Ndihmës Ekonomike”, në ish Komunën Llugaj (mungon akti i emërimit, por sipas librezës së punës, marrëdhëniet financiare kanë filluar në datën 15.10.2011). Me aktin nr. 1679, datë 20.04.2016, është deklaruar “Nëpunës civil”, në pozicionin e mësipërm.
10. \*\*\*\*\*, emëruar me urdhrin nr. 15, datë 01.09.2008, në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës Veterinere dhe Mbrojtjes së Ushqimit”, në Bashkinë Tropojë. Me aktin nr. 711/19, datë 10.06.2014, është deklaruar “Nëpunës civil”, në pozicionin e mësipërm.

**Konkluzion:** Komisioneri vlerëson se, në të gjitha rastet e analizuara më sipër, njësia përgjegjëse, ka zbatuar drejt ligjin në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit si “Nëpunës civil”, pasi rezulton se këta nëpunës i përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 67, pika 3, të ligjitnr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në aktet nënligjore, që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij.

- **I pozicion pune të shërbimit civil**, është plotësuar nga nëpunës civil ekzistues, për të cilin është deklaruar statusi i punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove”

Nga këqyrja e dokumentacionit të dosjeve personale rezulton se në **I rast**, pozicioni i shërbimit civil është plotësuar me punonjës ekzistues, i cili në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ishte i punësuar për një periudhë më pak se një vit.

Bëhet fjalë për punonjësën \*\*\*\*\*, e cila në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, ka qenë e emëruar në pozicionin “Inspektor i pritjes, barazisë gjinore dhe dhunës në familje”, në Bashkinë Tropojë (mungon akti i emërimit, marrëdhënia financiare ka filluar në datën 02.05.2014).

Nga përmbajtja e librezës së punës, konstatohet se marrëdhënia e punësimit për këtë punonjëse në pozicionin e punës “Inspektor i pritjes, barazisë gjinore dhe dhunës në familje”, në Bashkinë Tropojë ka qenë më pak se një vit. Me aktin nr. 57, datë 28.08.2015, nëpunësja \*\*\*\*\* është deklaruar “Nëpunës civil në periudhë prove” në këtë pozicion dhe në përfundim të periudhës së provës është konfirmuar “Nëpunës civil”, me aktin nr. 3617 datë 28.09.2016.

Aktualisht me aktin nr. 629/2 prot., datë 20.03.2018, të njësisë përgjegjëse të Bashkisë Tropojë është emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimit Publik”, nëpërmjet procedurës së konkurrimit, ngritje në detyrë (rast i cili do të trajtohet në paragrafët në vijim).

**Konkluzion:** Komisioneri vlerëson se, në rastin e analizuar më sipër, njësia përgjegjëse ka zbatuar drejt ligjin në lidhje me deklarinimin e statusit të punësimit si “Nëpunës civil në periudhë prove”, pasi punonjësja i përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në aktet nënligjore, që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij.

- **I pozicioni pune i shërbimit civil**, është plotësuar me nëpunës civil ekzistues, i cili ka qenë i punësuar për një periudhë kohe me pak se një vit dhe për të cilën është deklaruar statusi i punësimit “Nëpunës civil”

Bëhet fjalë për punonjësën \*\*\*\*\*, e cila në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me urdhrin nr. 1, datë 06.12.2013, ka qenë e emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Ndhmës Ekonomike”, në ish Komunën Bujan (sot njësi administrative e Bashkisë Tropojë). Rezulton se me aktin nr. 114/1 prot., datë 29.04.2015, njësia përgjegjëse, për këtë punonjëse ka deklaruar statusin e punësimit si “Nëpunës civil”, në pozicionin e mësipërm. Aktualisht, me aktin nr. 21, datë 19.08.2015, është transferuar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Ndhmës Ekonomike”, në Bashkinë Tropojë, si rezultat i riorganizimit administrativ – territorial dhe ristrukturimit të Bashkisë Tropojë.

Nga analiza e aktit të emërimit si dhe librezës së punës, konstatohet se, marrëdhënia e punësimit për këtë punonjëse në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Ndhmës Ekonomike”, ka qenë për një periudhë më pak se një vit. Në kuptim të nenit 67, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse pa të drejtë ka nxjerrë aktin e deklarinimit të statusit të punësimit si “Nëpunës civil”, ndërkohë që duhet të deklarohej me statusin “Nëpunës civil në periudhë prove”, duke anashkaluar në këtë mënyrë, detyrimet ligjore që parashikohen në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

## **Konstatim**

Në observacionin e paraqitur nga ana e institucionit të Bashkisë Tropojë, pretendohet se punonjësja e mësipërme është deklaruar “*Nëpunës civil*”, për pozicionin “*Përgjegjës i Zyrës së Ndihmës Ekonomike*”, në ish Komunën Bujan, me arsyetimin se, kjo punonjëse ka punuar për rreth 17 vjet në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil.

Në lidhje me këtë pretendim, konstatohet se, nga ana e institucionit është paraqitur librezja e punës së punonjësës \*\*\*\*\*. Nga këqyrja e këtij akti, rezulton se, nëpunësja në fjalë ka qenë e emëruar në pozicionin “*Përgjegjës i Degës së Thesarit Tropojë*” dhe është liruar nga ky pozicion në datën 03.12.2013, si pasojë e organizimit dhe ristrukturimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit.

Më tej, në referencë të dokumentacionit të administruar, rezulton se, me aktin nr. 1, datë 06.12.2013, të Kryetarit të Komunës, kjo nëpunëse është emëruar në pozicionin “*Përgjegjës i Ndihmës Ekonomike*”, në ish Komunën Bujan, pozicion në të cilin ka qenë e emëruar në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit për nëpunësin civil.

Për sa më sipër, Komisioneri sjell në vëmendje të njësisë përgjegjëse, se deklarimi si “*Nëpunës civil*”, i punonjësve ekzistues, në zbatim të nenit 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kërkon plotësimin e kritereve si më poshtë:

- Nëpunës civil ekzistues, punonjës ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”, apo,
- Të jenë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit.

Nga sa më sipër, arrihet në përfundimin se njësi përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 67, pika 4, të ligjit të sipërcituar, pasi nuk rezulton e provuar që marrëdhënia e punësimit për punonjësën \*\*\*\*\* në pozicionin *Përgjegjës i Zyrës së Ndihmës Ekonomike*”, në ish Komunën Bujan të ketë qenë më tepër se 1 (një) vit dhe nga ana tjetër, rezulton se emërimi i kësaj punonjëse në këtë pozicion nuk është bërë me procedurë konkurrimi, por me akt të përkohshëm emërimi.

Për këtë arsye, në projektraport grupi i punës ka arritur në konkluzionin se, njësi përgjegjëse duhet të ndryshojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit për punonjësën \*\*\*\*\* , detyrë e cila do të vijojë të mbetet edhe në raportin përfundimtar

**Konkluzion:** Komisioneri vlerëson se, në rastin konkret njësi përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 67, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, njësi përgjegjëse duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

- Të ndryshojë aktin administrativ nr. 114/1 prot., datë 29.04.2015, për deklarimin e statusit të punësimit për nëpunësen \*\*\*\*\* , duke e ndryshuar pozicionin e saj në

raport me shërbimin civil, nga “nëpunës civil”, në “nëpunës civil në periudhë prove”, për arsye se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), rezulton se kohëzgjatja e periudhës së punësimit, është më pak se 1 vit.

- Njësia përgjegjëse duhet të marrë masat që nëpunësja në fjalë të kryejë ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s.
  - Eprori direkt, të nxjerrë për nëpunësen vendimin e arsyetuar të konfirmimit ose jo, në përfundim të periudhës së provës. Gjatë arsyetimit të vendimit të konfirmimit, duke përfshirë evidentimin e bazës ligjore ku mbështetet procesi, duhet të argumentohet në mënyrë të qartë edhe përmbajtja e procesit, që përfshin datën e fillimit të periudhës së provës dhe plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, (të përmendet dokumenti i përfundimit të trajnimit të detyrueshëm dhe rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA).
- **1 pozicion i shërbimit civil**, është plotësuar me punonjës ekzistues, i cili në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka qenë i punësuar në një pozicion pjesë e shërbimit civil, por që nuk i përbush kriteret për të qenë nëpunës civil.

Në rastin konkret, bëhet fjalë për punonjësin \*\*\*\*\*, emëruar me urdhrin nr. 12, datë 11.04.2007, në pozicionin “Inspektor urbanistike”, në Bashkinë Tropojë.

Pozicioni i punës, ku ky punonjës ka qenë i emëruar në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas përcaktimeve të nenit 19, të po këtij ligji, klasifikohet në kategorinë e pozicioneve të nivelit ekzekutiv. Në zbatim të Lidhjes nr. 2, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, ndër kriteret e posaçme për pozicionet e nivelit ekzekutiv është përcaktuar diplomë e arsimit të lartë “Master Profesional”/“Bachelor”.

Nga verifikimi i dosjes së personelit, konstatohet se punonjësi \*\*\*\*\*, nuk përbush kriteret e pozicionit të punës, pasi rezulton se ai nuk disponon diplomë të arsimit të lartë. Në zbatim të pikës 7, të vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tropojë, duhet të kishte vendosur përfundimin e marrëdhënies së punësimit, pasi në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit për shërbimin civil, ky punonjës nuk i plotësonte kriteret për të qenë nëpunës civil, për shkak të nivelit arsimor.

### ***Konstatim***

Në observacionet e dërguara nga ana e institucionit të Bashkisë Tropojë, pretendohet se, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, punonjësi \*\*\*\*\* nuk ka qenë i emëruar në pozicion të shërbimit civil.

Komisioneri konstaton se, nga ana e njësies përgjegjëse nuk janë vënë në dispozicion akte të tjera administrative, të cilat të materializojnë këtë pretendim. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, konkluzioni i arritur nga grupi i punës në projektraport, do të vijojë të mbetet edhe në raportin përfundimtar, për arsye të përmendëm më sipër.

**Konkluzion:** Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse duhet të finalizojë procesin e deklarimit të statusit të punësimit për punonjës \*\*\*\*\*, i cili aktualisht është i punësuar në pozicion të shërbimit civil.

Për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, njësia përgjegjëse duhet të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për punonjës \*\*\*\*\*, duke evidentuar faktin se ky punonjës nuk zotëron diplomë të arsimit të lartë “*Master Profesional/Bachelor*”, ndërkohë që kjo është një kërkesë e parashikuar në Lidhjen nr. 2, ndarja 2/2 “*Përshkrimi i përgjithshëm i punës dhe kërkesat për pranimin në çdo klasë*”, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar.

Pozicioni i punës duhet të shpallet i lirë për tu plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

4.2 **Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me punonjës të emëruar me akte të përkohshme emërimi, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.**

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se, në institucionin e Bashkisë Tropojë, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, janë punësuar me akte emërimi të përkohshëm **18 punonjës**, të paraqitur si më poshtë, sipas pozicionit të punës dhe aktit të emërimit:

➤ **Administrata e Bashkisë**

1. \*\*\*\*\*, emëruar “*Specialist për topografinë*”, në Sektorin e Pronave dhe Haartografisë, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, me urdhrin nr. 33, datë 24.08.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
2. \*\*\*\*\*, emëruar “*Specialist i burimeve njerëzore*”, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, me urdhrin nr. 46, datë 15.03.2018, të Kryetarit të Bashkisë;
3. \*\*\*\*\*, emëruar “*Specialist i emergjencave civile*”, në Sektorin e Emergjencave Civile dhe Transportit, në Drejtorinë e Turizmit, Shërbimeve Publike dhe Mbështetëse, me urdhrin nr. 1, datë 11.01.2016.

➤ **Njësia administrative Bytyc**

4. \*\*\*\*\*, emëruar “*Specialist i bujqësisë dhe shërbimeve*”, me urdhrin nr. 1587 prot., datë 03.01.2018, të Kryetarit të Bashkisë;

5. \*\*\*\*\*, emëruar “*Punonjës i ndihmës ekonomike*”, me urdhrin nr. 1084/2, dat 01.06.2018, të Kryetarit të Bashkisë;

➤ **Njësia administrative Margegaj**

6. \*\*\*\*\*, emëruar “*Inspektor i shërbimit pyjor dhe sekretari/arkiv*”, me urdhrin nr. 1190/1 prot., datë 03.01.2018, të Kryetarit të Bashkisë;
7. \*\*\*\*\*, emëruar “*Punonjës i ndihmës ekonomike*”, me kontratën e datës 03.01.2015;

➤ **Njësia administrative Fierzë**

8. \*\*\*\*\*, emëruar “*Inspektor i shërbimit të pyjeve dhe kullotave*”, me urdhrin nr. 2098/1 prot., datë 03.01.2018, të Kryetarit të Bashkisë;
9. \*\*\*\*\*, emëruar “*Punonjës i ndihmës ekonomike dhe sekretar/arkivit*”, me urdhrin nr. 37, datë 18.03.2016;

➤ **Njësia administrative Lekbibaj**

10. \*\*\*\*\*, emëruar “*Specialist i bujqësisë*”, me urdhrin nr. 112, datë 15.08.2016, të Kryetarit të Bashkisë.
11. \*\*\*\*\*, emëruar “*Punonjës i ndihmës ekonomike dhe sekretar/arkivit*”, me urdhrin nr. 1596 prot., datë 03.01.2018, të Kryetarit të Bashkisë;

➤ **Njësia administrative Tropojë**

12. \*\*\*\*\*, emëruar “*Punonjës i ndihmës ekonomike*”, me urdhrin nr. 78, datë 29.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë;

➤ **Njësia administrative Bujan**

13. \*\*\*\*\*, emëruar “*Punonjës i ndihmës ekonomike*”, me urdhrin nr. 2466/1 prot., datë 03.01.2018, të Kryetarit të Bashkisë;

➤ **Njësia administrative Llugaj**

14. \*\*\*\*\*, emëruar “*Punonjës i ndihmës ekonomike dhe mbajtës i dokumentacionit të bujqësisë*”, me urdhrin nr. 2457/1, datë 03.01.2018, të Kryetarit të Bashkisë;

➤ **Drejtoria e Shërbimit Pyjor**

15. \*\*\*\*\*, emëruar “*Përgjegjës Sektori*”, me vendimin nr. 71, datë 26.05.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
16. \*\*\*\*\*, emëruar “*Specialist i pyjeve dhe kullotave*”, me vendimin nr. 47, datë 31.03.2016, të Kryetarit të Bashkisë;
17. \*\*\*\*\*, emëruar “*Specialist i pyjeve*”, me vendimin nr. 96, datë 27.07.2016, të Kryetarit të Bashkisë;

18. \*\*\*\*\*, emëruar “*Inxhinier pyjesh*”, me vendimin nr. 26, datë 26.02.2018, të Kryetarit të Bashkisë;

### ***Konstatim***

Komisioneri konstaton se, në observacionet e sjella me shkresën nr. 2718/2 prot., datë 04.12.2018, njësia përgjegjëse ka argumentuar, se 2 nga punonjësit e përmendur në listën më sipër nuk ndodhen në kushtet e emërimeve të përkohshme në kundërshtim me ligjin, pasi rezulton se, për ata është nxjerrë akti i deklarimit të statusit të punësimit. Bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

- \*\*\*\*\*, i cili me aktin nr. 26/4 prot., datë 26.04.2015, është deklaruar “*Nëpunës civil*”, në pozicionin “*Përgjegjës i Zyrës së Ujësjetllësit*”, në ish komunën Margegaj, sot njësi administrative e Bashkisë Tropojë;
- \*\*\*\*\*, e cila me aktin nr. 1680 prot., datë 20.04.2016, është deklaruar “*Nëpunës civil*”, në pozicionin “*Specialist i ndihmës ekonomike*”, në Njësinë Administrative Tropojë Fshat.

Për të vlerësuar rrethanat e rastit, u verifikua dokumentacioni përkatës që materializon këtë pretendim, nga shqyrtimi i të cilit rezultoi se procedurat e deklarimit të statusit të punësimit për 2 rastet e sipër përmendura, nuk i janë vënë në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes gjatë momentit të vizitës në subjekt nga ana e njësisë përgjegjëse.

- Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, referuar librezës së punës, rezulton se punonjësi \*\*\*\*\*, prej datës 01.02.2011, ka qënë i punësuar në Komunën Margegaj në pozicionin e punonjësit të “*Tatim taksave*”. Në vijim, me aktin nr. 26/4 prot., datë 26.04.2015, rezulton se \*\*\*\*\* është deklaruar nëpunës civil i konfirmuar në pozicionin “*Përgjegjës i zyrës së Ujësjetllësit*” në ish komunën Margegaj, sot njësi administrative e Bashkisë Tropojë. Më tej, me aktin nr. 41 datë 08.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, ky punonjës emërohet në pozicionin “*Specialist i ndihmës ekonomike*”, në njësinë administrative Margegaj. Sa më sipër, evidentohet fakti se akti i deklarimit nëpunës civil i konfirmuar për këtë punonjës, ka dalë në kundërshtim me ligjin, pasi pozicioni i punës “*Përgjegjës i zyrës së Ujësjetllësit*”, nuk përfshihet në shërbimin civil.

Në këto rrethana, në zbatim të nenit 67 të ligjit për nëpunësin civil, si dhe të nenit 109 dhe 113 të Kodit të Procedurave Administrative, duhet të anulohet edhe akti nr. 26/4 prot., datë 26.04.2015, nëpërmjet të cilit është deklaruar statusi i punësimit si nëpunës civil për punonjësin \*\*\*\*\*, si akt që ka dalë në kundërshtim me ligjin.

Në këto kushte, konkluzioni i arritur nga grupi i punës në projektraport, do të vijojë të mbetet edhe në raportin përfundimtar, për arsytet që përmendëm më lart.

- Përsa i përket rastit të punonjësës \*\*\*\*\*, nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se me sipas librezës së punës në datë 07.01.1995, është emëruar “*Përgjegjëse e zyrës së*



*mbrojtjes shoqërore*”, në Komunën Tropojë. Më tej, me aktin nr. 15 datë 22.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, është emëruar në pozicionin “*Specialiste e ndihmës ekonomike*”.

Sa më sipër, rezulton se njësia përgjegjëse ka vepruar drejt, duke nxjerrë aktin nr. 1680 prot., datë 20.04.2016, për deklarimin “*Nëpunës civil*” të nëpunëses \*\*\*\*\*, në pozicionin “*Specialist i ndihmës ekonomike*”, në Njësinë Administrative Tropojë.

Në referencë të dokumentacionit të administruar, pasi analizoi aktet e paraqitura nga institucioni si pjesë e observacioneve, Komisioneri e vlerëson si të drejtë pretendimin e njësisë përgjegjëse të Bashkisë Tropojë, duke mos e evidentuar në vendimin e paralajmërimit.

***Konkluzion:*** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil konstaton se, aktet e emërimit të evidentuara më sipër, si në rastin e administratës së bashkisë ashtu edhe të njësisë administrative, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi, për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele ose ngritjes në detyrë. Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me përcaktimet ligjore të mësipërme, është absolutisht i pavlefshëm.

Komisioneri vëren se, duke vepruar në këtë mënyrë, titullari i institucionit, ka vepruar në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, ç’ka në vështrim të nenit 108, pikat i) dhe ii), të shkronjës “a” dhe shkronjës “ç”, të ligjit nr.44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, i bën aktet absolutisht të pavlefshëm.

Për më tepër, ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në pikën 4, të nenit 23, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në implementimin e kësaj dispozite në praktikë.

Në vijim të këtij arsytimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Tropojë, duhet të konstatojë në këto veprime administrative, ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart, dhe të **konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të këtyre akteve dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës dhe financiare.** të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore dhe më tej, duke i shpallur si të lira këto pozicione, për t’u plotësuar në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.

Pozicionet në fjalë, duhet të plotësohen me anën e procedurave të konkurrimit të hapur, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë.

Njësia përgjegjëse, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, duhet të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në Kreun IV *“Pranimi në shërbim civil”*, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”* dhe vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, *“Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”*.

## **II. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.**

Në zbatim të programit të mbikëqyrjes, u verifikua respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës, të përcaktuara me hollësi në Vendimin nr.142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, të ndryshuar, dhe Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, *“Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”*, akte që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar.

Këto akte nënligjore, në përmbajtjen e tyre, kanë përcaktuar rastet kur një institucion pjesë e shërbimit civil, duhet të hartojë përshkrimet e punës, procedurat e hollësishme që duhet të ndiqen gjatë procesit të hartimit të përshkrimeve të punës për pozicionet e shërbimit civil, nëpunësit dhe strukturat përgjegjëse për hartimin e tyre, si dhe organin që ka kompetencën për të bërë miratimin e tyre, dhe po ashtu, vazhdimësinë e procesit, me depozitimin e tyre pranë Departamentit të Administratës Publike apo njësisë përgjegjëse në institucionet e tjera të shërbimit civil.

Në pikën 14, të Kreut IV, *“Procedura dhe formati i përshkrimit të punës”*, të VKM-së nr.142, datë 12.3.2014, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni”*, dhe më tej, në Kreun VI, *“Dispozita tranzitore”*, pika 40, ka parashikuar që, *të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil, të përfundojnë hartimin e përshkrimit të punës, deri në datën 1 korrik, 2014.*

Në rastin konkret, me fillimin e efekteve juridike të legjislacionit të ri të shërbimit civil, Bashkia Tropojë, si organ i vetëqeverisjes vendore pjesë e shërbimit civil, duhet të hartonte përshkrimet e reja të punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, sipas standardeve dhe afateve të përcaktuara në aktin nënligjor.

Nga ana tjetër, pas riorganizimit administrativo-territorial në organet e qeverisjes vendore, siç e kemi thënë me sipër në material, ka ndryshuar organizimi dhe funksionimi i tyre, sipas ligjit nr. 139/2015, “*Për vetëqeverisjen vendore*”.

Këto ndryshime, janë reflektuar në strukturën e institucionit, të cilat konsistojnë në shtimin apo riorganizimin e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil. Pra, me *miratimin e legjislacionit specifik* mbi bazën e të cilit funksionon institucioni, ka ndryshuar edhe *mënyra e organizimit të tij*, kushte këto, të cilat parashikojnë hartimin e përshkrimeve të reja të punës në bazë të riorganizimit të pozicioneve të punës.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes së kryer, u konstatua se, në subjektin e kontrolluar *janë hartuar përshkrimet e punës për 37 pozicione*, pjesë e aparatit të Bashkisë Tropojë, të cilat njësia përgjegjëse i ka konsideruar pozicione që përfshihen në skemën e shërbimit civil.

Nga përmbajtja e akteve të përshkrimit të punës të verifikuara në subjekt, konstatohet se, në këto akte janë përfshirë elementët, sipas modelit standard të miratuar në aktin nënligjor përkatës, si dhe të dhënat për pozicionin e punës, misionin, qëllimi i përgjithshëm i pozicionit të punës, detyrat kryesore, përgjegjësitë kryesore, zgjidhja e problemeve, vendimmarrja, mjedisi menaxherial, mbikëqyrja, stafi në varësi, kushtet e punës.

Në zbatim të pikës 18, germa “ç”, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, përshkrimet e punës, për institucionet e qeverisjes vendore, miratohen nga Sekretari i Përgjithshëm. Nisur nga fakti, që ky pozicion pune, nuk është parashikuar në strukturën aktuale të Bashkisë Tropojë, duke ndjekur shkallën e hierarkisë, përshkrimet e punës duhet të miratohen nga titullari i këtij institucioni.

Në rastin konkret, konstatohet se, Kryetari i Bashkisë ka nënshkruar formularët e përshkrimit vetëm për pozicionet e nivelit të mesëm drejtues, me emërtesën “*Drejtor Drejtorie*”, ndërkohë që përshkrimet e punës për pozicionet e nivelit të ulët drejtues dhe nivelit ekzekutiv janë nënshkruar nga drejtorët e drejtorive përkatëse, në cilësinë e eprorit direkt të pozicionit respektiv të punës.

Nga ana tjetër, konstatohet se, *nuk janë hartuar përshkrimet e punës për pozicionet e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, të njësive administrative dhe të administratës së bashkisë*, të cilat në përmbajtje të këtij raporti janë analizuar dhe trajtuar si pozicione që duhet të përfshihen në skemën e shërbimit civil.

**Konkluzion:** Komisioneri, vlerëson se, përshkrimet e punës për 37 pozicione pune, janë hartuar sipas formatit të përcaktuar në vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, por nuk është finalizuar procesi me miratimin e tyre nga titullari i institucionit, sipas procedurës së përcaktuar në dispozitat e këtij akti nënligjor. Për të rregulluar ligjshmërinë në këtë rast, duhet të vepohet si më poshtë:

- Njësia e burimeve njerëzore, duhet të marrë masa, që përshkrimet e punës të hartuara sipas formatit standard të miratohen nga drejtuesi i institucionit dhe më pas të

nënshkruhen nga nëpunësi civil që punon në pozicionin për të cilin është hartuar përshkrimi i punës dhe drejtori i drejtorisë përkatëse, i cili paraqitet në cilësinë e eprorit direkt.

- Për pozicionet e punës, të cilat nuk janë përfshirë në skemën e shërbimit civil, njësia përgjegjëse duhet të fillojë menjëherë punën për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës, në përputhje me legjislacionin specifik të fushës dhe formatin standard të miratuar, ashtu siç përcaktohet në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, lidhjen 4, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe në udhëzimin nr. 2, datë 07.4.2014, të Departamentit të Administratës Publike “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”.

### **III. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.**

Administrimi i shërbimit civil në bazë të planit vjetor të pranimit, është parashikuar në nenin 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Më tej, në mbështetje të kësaj dispozite është miratuar vendimi nr. 108, datë 26.2.2014 i Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, në të cilin janë përcaktuar procedurat e hollësishme për përgatitjen, miratimin, afatin e miratimit dhe mënyrën e bërjes publike të planit vjetor të punësimit.

Në zbatim të nenit 18, pika 2, të ligjit të sipërcituar, njësitë e qeverisjes vendore në fund të çdo viti duhet të hartojnë planet vjetore, për vitin pasardhës, i cili duhet të miratohet jo më vonë se muaji shkurt, të cilat në zbatim të pikës 13, të aktit nënligjor të sipërcituar, duhet të publikohen në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare si dhe në stendat për njoftime publike të institucionit.

Në zbatim të pikës 2, të vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, njësia përgjegjëse në vendimin për planifikimin vjetor, duhet të përcaktojë a) numrin e vendeve vakante për të cilat duhet të shpallet konkurrimi për çdo kategori dhe klasë dhe b) grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm.

Ky vendim, i cili përcakton në mënyrë të hollësishme procedurën që duhet të ndiqet për hartimin e planit vjetor, në nenin 3 të tij, përcakton se në planifikimin vjetor të pranimit në shërbimin civil, duhet të mbahet parasysh mbushja e moshës së pensionit të nëpunësit civil, parashikimi i vendeve të reja në shërbimin civil dhe ecuria e krijimit të vendeve vakante në shërbimin civil për arsye të tjera të paparashikuara.

Konkretisht, rezulton se, institucioni i mbikëqyrur, me vendimin nr. 5, datë 23.01.2018, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, ka miratuar planin vjetor të pranimeve në shërbimin civil për vitin 2018. Nga përmbajtja e këtij akti, konstatohet se është parashikuar plotësimi i **14** pozicioneve të lira, të cilat paraqiten si më poshtë:

- 1 pozicion “Përgjegjës i Sektorit për Auditimin e Brendshëm” – kategoria e pagës III-a/1;

- 1 pozicion “Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike” - kategoria e pagës III-a/1;
- 1 pozicion “Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave” - kategoria e pagës III-a/1;
- 1 Pozicion “Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit Rural” - kategoria e pagës III-a/1;
- 1 pozicion “Kryeinspektor për mjedisin e kontrollin e territorit” – kategoria e pagës IV-b;
- 1 pozicion “Inspektor për mbrojtjen e mjedisit e kontrollin e territorit” – kategoria e pagës IV-a;
- 1 pozicion “Specialist finance” – kategoria e pagës IV-a;
- 1 pozicion “Specialist i burimeve njerëzore” – kategoria e pagës IV-a;
- 2 pozicione “Specialist i planifikimit dhe zhvillimit të territorit” – kategoria e pagës IV-a;
- 1 pozicion “Specialist i auditit të brendshëm” – kategoria e pagës IV-a;
- 1 pozicion “Specialist jurist dhe i prokurimeve publike” – kategoria e pagës IV-a;
- 1 pozicion “Specialist i emergjencave civile” – kategoria e pagës IV-a;
- 1 pozicion “Specialist për të drejtat e mbrojtjen e fëmijëve e grave të dhunuara” – kategoria e pagës IV-a;

Në momentin e mbikëqyrjes rezulton se **7** pozicione (3 pozicione të nivelit të ulët drejtues dhe 4 pozicione të nivelit ekzekutiv) të planifikuar për rekrutim, janë plotësuar nëpërmjet procedurës së konkurrimit, ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil, në përputhje me përcaktimet e neneve 22, 23, 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. (Këto raste trajtohen më hollësisht në kapitullin në vijim të këtij raporti).

Për pozicionet “Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit Rural”, “Inspektor për mbrojtjen e mjedisit dhe kontrollit të territorit” dhe “Kryeinspektor për mjedisin e kontrollit të territorit”, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore ka kërkuar plotësimin e këtyre pozicioneve për shkak të mbushjes së moshës së pensionit nga punonjësit, të cilët në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes ushtrojnë detyrën në pozicionet e sipërcituara.

**Konkluzion:** Komisioneri, vlerëson se, Bashkia Tropojë ka vepruar në përputhje me përcaktimet e nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 108, datë 26.2.2014 i Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, në përgatitjen e planit vjetor për vitin kalendarik 2018.

#### **IV. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.**

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, u verifikuan emërimet në pozicionet e shërbimit civil, nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, të kryera prej datës 26.02.2014, që është data e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, deri në momentin e mbikëqyrjes, të cilat po i paraqesim si më poshtë:

##### **a) Emërime, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive**

Për periudhën objekt mbikëqyrje, në zbatim të nenit 22 dhe 23, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë aspekt të ligjit, evidentohen **18** raste, të pranimit në shërbimin civil përmes konkurrimit të hapur. Konkretisht:

### Për vitin kalendarik 2016

1. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 4120/1 prot., datë 11.11.2016, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist i tatim taksave për realizimin e të ardhurave*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Drejtorinë Ekonomike, në Bashkinë Tropojë;
2. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 4121/1 prot., datë 11.11.2016, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist i tatim taksave (për regjistrimin e subjekteve dhe kontrollin mbi pagesën e taksave vendore)*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Drejtorinë Ekonomike, në Bashkinë Tropojë;
3. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 4112/1 prot., datë 11.11.2016, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist IT*”, në Sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në Bashkinë Tropojë;
4. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 4118/1 prot., datë 11.11.2016, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist e pagave dhe arkivit, dokumenteve të financës*”, në Sektorin e Buxhetit të Financës, pranë Drejtorisë Ekonomike, në Bashkinë Tropojë;
5. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 4123/1 prot., datë 11.11.2016, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist i arsimit, shëndetësisë, kulturën dhe sportin*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, në Bashkinë Tropojë;
6. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 4540 prot., datë 23.12.2016, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist i turizmit dhe informacionit*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, në Bashkinë Tropojë;
7. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 4540/4, datë 27.12.2016, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist i Auditit të brendshëm*”, në Sektorin e Auditit të Brendshëm, Bashkia Tropojë;

### Për vitin kalendarik 2017

8. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 4540/3, datë 05.01.2017, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Auditit të Brendshëm, në Bashkinë Tropojë;
9. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 1494/3 prot., datë 26.05.2017, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist finance*”, në Sektorin e Buxhetit dhe Financës, në Drejtorinë Ekonomike, Bashkia Tropojë;
10. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 1495/3, datë 26.05.2017, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist finance dhe arkivit financës*”, në Sektorin e Buxhetit dhe Financës, në Drejtorinë Ekonomike, Bashkia Tropojë;
11. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 1537/1 prot., datë 02.06.2017, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist jurist*”, në Drejtorinë Ekonomike, në Bashkinë Tropojë;
12. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 3419/3, datë 15.11.2017, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist për i mbrojtjes së konsumatorit*”, në Sektorin e e Mbrojtjes së Konsumatorit, në Drejtorinë e Turizmit, Shërbimeve Publike dhe Mbështetëse, në Bashkinë Tropojë;
13. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 3421/3, datë 15.11.2017, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist për mbajtjen e dokumentacionit*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, në Bashkinë Tropojë;

14. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 3422/3 prot., datë 15.11.2017, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist i tatim taksave për tregun dhe kontratat e qiradhënies me subjektet*”, në Sektorin e Tatim Taksave, në Drejtorinë Ekonomike, në Bashkinë Tropojë;

### **Për vitin kalendarik 2018**

15. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 277/3 prot., datë 26.03.2018, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Punonjës social për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe barazisë gjinore*”, në Sektorin e Ndihmës Ekonomike, në Drejtorinë Ekonomike, në Bashkinë Tropojë;
16. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 780/1 prot., datë 05.04.2018, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist i pronave dhe hartografisë*”, në Sektorin e Pronave dhe Hartografisë, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në Bashkinë Tropojë;
17. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 272/3 prot., datë 26.03.2018, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist jurist*”, në Sektorin e Auditit të Brendshëm, në Bashkinë Tropojë;
18. \*\*\*\*\*, me 1637/3 prot., datë 13.06.2018, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist i financës për asetet dhe kontabilitetin*”, në Sektorin e Buxhetit dhe Financës, në Drejtorinë Ekonomike, në Bashkinë Tropojë.

Në kuptim të përcaktimeve të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, vërehet se, për këto procedura konkurrimi është vepruar si më poshtë:

- Është publikuar akti shpalljes për plotësimin e një pozicionit të lirë pune në shërbimin civil në portalin e “*Shërbimit Kombëtar të Punësimit*”, në të cilën evidentohen kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të pozicionit të punës. Njëkohësisht, ky akt ndodhet i administruar dhe në dosjet përkatëse të konkurrimit.
- Është publikuar në portalin e “*Shërbimit Kombëtar të Punësimit*” akti i shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “*lëvizja paralele*”, ashtu dhe për fazën e dytë “*pranim në shërbimin civil*”, akte të cilat janë të administruara në dosjen përkatëse.
- Është publikuar shpallja për përfundimin e lëvizjes paralele pa kandidatë, në rastet kur nuk ka pasur kandidatë të kualifikuar për të vazhduar më tej me fazën e vlerësimit;
- Është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranim, për pranimin në nivelin ekzekutiv, me përbërje në përputhje me kërkesat e akteve nënligjore të sipërcituara.
- Është publikuar akti i shpalljes së kandidatit të nxjerrë fitues me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës, për procedurën e pranimin në shërbimin civil në portalin e “*Shërbimit Kombëtar të Punësimit*”.
- Njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e emërimit për nëpunësit e mësipërm, sipas procedurës dhe afateve ligjore, të përcaktuara në ligjin për shërbimin civil dhe në aktet nënligjore që rregullojnë këtë aspekt.

#### **b) Emërime, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele**

Në rastin e institucionit të mbikëqyrur, në zbatim të 25, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar nëpërmjet lëvizjes paralele, me akte emërimi të nxjerrë nga njësia përgjegjëse është emëruar nëpunësja \*\*\*\*\*, e cila me aktin nr. 22, datë 08.02.2016, është emëruar “*Nëpunës civil*”, në pozicionin “*Administrator për paaftësinë dhe invaliditetin*”, në Sektorin e Ndihmës Ekomomike, në Drejtorinë Ekonomike, në Bashkinë Tropojë;

#### **c) Emërime, nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë**

Nga dokumentacioni i administruar gjatë mbikëqyrjes në Bashkinë Tropojë, konstatohet se, në zbatim të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, nëpërmjet ngritjes në detyrë janë emëruar nëpunësit si më poshtë:

1. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 4124 prot., datë 11.11.2016, është emëruar nëpunës civil në pozicionin “*Drejtor*”, i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në Bashkinë Tropojë;
2. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 1496/2 prot., datë 26.05.2017, është emëruar nëpunës civil, në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit*”, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në Bashkinë Tropojë;
3. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 1232/2 prot., datë 20.03.2018, është emëruar nëpunës civil në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Tatim-Taksave*”, në Drejtorinë e Ekonomisë, në Bashkinë Tropojë;
4. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 629/2, datë 20.03.2018, është emëruar nëpunës civil në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe i Prokurimit Publik*”, në Bashkinë Tropojë;
5. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 256/2 prot., datë 20.03.2018, është emëruar nëpunës civil në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm*”, në Bashkinë Tropojë;

Në lidhje me procedurat e mësipërme të konkurrimit, nëpërmjet ngritjes në detyrë, vërehet se, nga ana e njësisë përgjegjëse janë respektuar të gjitha etapat e përcaktuara në dispozitat e vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesëm drejtuese*”.

#### **d) Emërime, nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, për kandidatë nga jashtë**

Në kuptim të nenit 26, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, rezulton se, për plotësimin e vendeve të lira për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, të vendoset zhvillimi i procedurës së konkurrimit edhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil, të cilët plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira. Sipas kësaj dispozite, plotësimi i vendeve të lira në këtë kategori, nuk mund të kalojë 20% të numrit total të vendeve të lira në çdo vit kalendarik.

Nga analiza e dokumentacionit të administruar, rezulton se në 4 raste është aplikuar procedura e konkurrimit, nëpërmjet ngritjes në detyrë, për kandidatë nga jashtë shërbimit civil. Bëhet fjalë për nëpunësit:



## Për vitin kalendarik 2016

1. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 4540/2, datë 23.12.2016, është emëruar nëpunës civil në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civil dhe Transportit”, në Drejtorinë e Turizmit, Shërbimeve Publike dhe Mbështetëse, në Bashkinë Tropojë;
2. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 4540/1, datë 23.12.2016, është emëruar nëpunës civil në pozicionin “Drejtor”, në Drejtorinë e Turizmit, Shërbimeve Publike dhe Mbështetëse, në Bashkinë Tropojë;
3. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 4540/3, datë 27.12.2016, është emëruar nëpunës civil në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm”, në Bashkinë Tropojë;

Rezulton se, me vendimin nr. 130, datë 14.10.2016, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, “Për pranimin nga jashtë në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, për pozicionet e mësipërme është miratuar zhvillimi i procedurës së ngritjes në detyrë edhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil.

## Për vitin kalendarik 2017

4. \*\*\*\*\*, me aktin nr. 1492/3, datë 26.05.2017, është emëruar nëpunës civil në pozicionin “Drejtor”, në Drejtorinë Ekonomike, në Bashkinë Tropojë.

Në zbatim të nenit 26, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Kreut III, pika 43, të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, rezulton se me vendimin nr. 59/1, datë 25.04.2017, të Kryetarit të Bashkisë, “Për pranimin nga jashtë në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, është miratuar pjesëmarrja e kandidatëve nga jashtë shërbimit civil, për procedurën e konkurrimit nëpërmjet ngritjes në detyrë për pozicionin e mësipërm.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar dhe për sa është pasqyruar më sipër, rezulton se, plotësimi i pozicioneve të mësipërme, me kandidatë nga jashtë, nuk ka kaluar 20% të numrit total të vendeve të lira të institucionit të Bashkisë Tropojë, për vitin kalendarik 2016 dhe 2017.

**Konkluzion:** Komisioneri vlerëson se, procedurat e konkurrimit, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, janë zhvilluar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.

## **V. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës**

Nëpunësit civil që emërohen për herë të parë në shërbimin civil i nënshtrohen një periudhe prove. Afati i periudhës së provës si dhe detyrat që duhet të përmbushë nëpunësi dhe institucioni përgjatë kësaj periudhe dhe në përfundim të saj, janë të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Kreun V, të vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të

Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, (për të gjitha ato procedura që kanë filluar gjatë kohës që ka qenë në fuqi kjo VKM); si dhe në Kreun VI, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Ndërsa për nëpunësit dhe punonjësit ekzistues, (nëpunësit dhe punonjësit që fillimi i efekteve të ligjit i gjeti në funksione të shërbimit civil) dhe që kishin një periudhë punësimit më të vogël se një vit, në pikën 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është përcaktuar se për ta zbatohet neni 24, i këtij ligji dhe se periudha e provës fillon nga fillimi i efekteve juridike të ligjit.

Në mbështetje të këtyre dispozitave ligjore, nëpunësi në periudhë prove është i detyruar të ndjekë programin e detyrueshëm të trajnimit për periudhën e provës pranë ASPA-s dhe udhëzimet e nëpunësit më të vjetër civil, nën kujdesin e të cilit ai është vendosur.

Eprori direkt i nëpunësit në periudhë prove, duhet të caktojë nëpunësin më të vjetër nën kujdesin e të cilit do të vendoset nëpunësi civil në periudhë prove, të bëjë vlerësimin e rezultateve individuale në punë për periudhën e provës dhe të nxjerrë vendimin për përfundimin e periudhës së provës.

Në zbatim të planit të mbikëqyrjes, u verifikua tërësia e veprimeve të kryera për konfirmimin e nëpunësve civilë, të cilët i janë nënshtruar periudhës së provës dhe që aktualisht vazhdojnë marrëdhëniet e punësimit me institucionin.

Gjatë procesit të verifikimit në institucionin e Bashkisë Tropojë rezultoi se, gjatë vitit 2016 ka përfunduar periudhën e provës 1 nëpunës, i cili në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, periudhën e punësimit e kishte më pak se një vit. Bëhet fjalë për punonjësen:

- \*\*\*\*\*\*, për të cilën me aktin nr. 57, datë 28.08.2015, është deklaruar statusi i punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove”, për pozicionin e punës “Inspektor i pritjes, barazisë gjinore dhe dhunës në familje”, në Bashkinë Tropojë. Në përfundim të periudhës së provës, rezultoi se, ky proces është finalizuar me nxjerrjen e aktit të konfirmimit nr. 3617, datë 28.09.2016, i cili rezultoi se jetë depozituar në dosjen personale të kësaj nëpunëseje.

Njëkohësisht, u vërejt se, përgjatë vitit 2017 dhe 2018 kanë përfunduar periudhën e provës 10 nëpunës civilë, të cilët janë emëruar nëpërmjet procedurës së konkurrimit, pranim në shërbimin civil (\*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*).

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, vërehet se janë kryer veprimet si më poshtë:

- Gjatë periudhës së provës, nëpunësit kanë kryer ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s dhe në fund të trajnimit i janë nënshtruar testimit. Bazuar në pikën 2, të Kreut

IV, të vendimit nr. 138, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimin e nëpunësve civilë”, i ndryshuar, trajnimi për periudhën e provës pranë ASPA-s, konsiderohet i ndjekur me sukses, nëse nëpunësi merr të paktën 50 % të pikëve në testim. Nga verifikimi i vërtetimeve (certifikatave) të lëshuara nga ASPA rezulton se, në testimin përfundimtar nëpunësit janë vlerësuar me mbi 50 % të pikëve.

- Nëpunësve iu është bërë vlerësimi i rezultateve individuale në punë, për periudhën e provës, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore.
- Në përfundim të periudhës së provës, për të **10** nëpunësit \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , janë nxjerrë aktet e konfirmimit, akte të cilat rezultojnë të jenë të depozituara në dosjet personale të nëpunësve.
- Në zbatim të Kreut VI, pika 13, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tropojë, ka vijuar më tej duke nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit.

Konstatohet se, për nëpunësit \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , të emëruar në pozicionet e kategorisë ekzekutive dhe të rekrutuar sipas procedurës së konkurrimit, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, afati i periudhës së provës nuk ka përfunduar në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes në institucion.

**Konkluzion:** Komisioneri vlerëson se, aktet e konfirmimit pas përfundimit të periudhës së provës për punonjësit e mësipërm, janë nxjerrë në respektim të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Kreut VI, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

## **VI. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe mënyra e realizimit të procesit nga zyrtarët kompetentë.**

Vlerësimi i rezultateve në punë të nëpunësve civilë është parashikuar në nenin 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Kjo dispozitë parashikon se vlerësimi i rezultateve në punë është një proces që realizohet çdo 6 muaj. Ndërsa në rastin e vlerësimit të rezultateve në punë në përfundim të periudhës së provës, periudha e vlerësimit është një vit dhe llogaritet nga data e emërimit të nëpunësit civil.

Më tej, në vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, ndryshuar me vendimin nr. 252, datë 30.03.2016, të Këshillit të Ministrave, janë përcaktuar procedurat që duhet të ndiqen për të vlerësuar nivelin e realizimit të objektivave të vendosura, vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit; detyrat e

zyrtarëve të përfshirë në procesin e vlerësimit; nivelet e shkallëzuara të vlerësimit si dhe të drejtat e nëpunësit në rastet kur ai nuk është dakord me vlerësimin përfundimtar.

Në kuptim të dispozitave ligjore si më sipër, procesi i vlerësimit të rezultateve në punë është një proces i vazhdueshëm, i cili konsiston në zhvillimin e fazës së planifikimit, në të cilën duhet të identifikohen objektivat kryesore të punës dhe sjelljet profesionale që duhet të përmbushë nëpunësi; zhvillimin e fazës së bisedimeve të ndërmjetme për të vlerësuar progresin e nëpunësit që i nënshtrohet vlerësimit; si dhe në vlerësimin përfundimtar të rezultateve në punë, ku zyrtari raportues, bën një vlerësim të përmbledhur në arritjen e objektive kryesore të punës për nëpunësin që do të vlerësohet.

Në zbatim të programit të kontrollit, për të gjithë nëpunësit që në momentin e mbikëqyrjes vazhdojnë marrëdhënien e punësimit me institucionin, u verifikuan vlerësimet e rezultateve në punë për periudhën Korrik - Dhjetor 2017, në institucionin e Bashkisë Tropojë.

Duke pasur parasysh katër nivelet e vlerësimit “shumë mirë”, “mirë”, “kënaqshëm” dhe “jo kënaqshëm”, nga verifikimet e kryera, vlerësimi përfundimtar paraqitet si më poshtë:

**Tabela nr. 1:** Niveli i vlerësimit të nëpunësve civilë të institucionit të Bashkisë Tropojë, për periudhën e vlerësimit Korrik - Dhjetor 2017, për nëpunës që aktualisht ushtrojnë detyrën në institucion.

Periudha e vlerësimit	Korrik – Dhjetor 2017			
	Shumë mirë	Mirë	Kënaqshëm	Jo kënaqshëm
Numri i nëpunësve civilë	4	12	-	-
Numri i nëpunësve civilë në periudhë prove	1	8	-	-
Numri i nëpunësve civilë që vazhdojnë periudhën provës	8			
<b>Totali</b>	<b>33</b>			

Gjatë verifikimit u konstatua se, formularët e vlerësimit të punës janë hartuar sipas formatit të miratuar në Lidhjen nr. 2, pjesë e vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, ku janë materializuar të gjitha rubrikat që kanë të bëjnë me të dhënat personale (ndarja A); të dhënat për kontekstin e punës ku identifikohen objektivat e institucionit dhe të njësisë organizative ku bën pjesë nëpunësi (ndarja B); objektivat dhe matësit e performancës, ku duke mbajtur parasysh përshkrimin e punës, bëhet vlerësimi për çdo objektiv (ndarja C); sjellja profesionale, e cila ka të bëjë me saktësinë në punën e kryer dhe realizimin në kohë, punën në grup e marrëdhëniet me kolegët, shpeshhtësinë e orëve të punës jashtë orarit, kërkesën për këshillim, trajnim dhe ngritjen profesionale (ndarja Ç); vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve në punë ku bëhet një vlerësim i përmbledhur i arritjes së objektive kryesore të punës nga nëpunësit.

Nga këqyrja e këtij procesi, konstatohet se, formularët e vlerësimit janë nënshkruar nga personat e përfshirë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punës, siç janë “Zyrtari raportues”, “Zyrtari kundërfirmues” dhe “Zyrtari autorizues”, ku nuk evidentohen raste të mosmarrëveshjes midis tyre, në lidhje me nivelin e vlerësimit apo raste të vlerësimit nga zyrtari autorizues (ndarja DH), për shkak të pretendimeve të nëpunësit në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë.

Njëkohësisht, konstatohet se, vlerësimi me pikë sipas rubrikave përkatëse, pjesë përbërëse e formularit të vlerësimit të rezultateve në punës, shoqërohet me komentet përkatëse, arsyet e vlerësimit si dhe rekomandimet dhe vërejtjet e nevojshme, të cilat krijojnë bindjen e realizimit të një vlerësimi objektiv dhe të efektshëm të performancës dhe arritjes së nëpunësit civilë gjatë kryerjes së detyrave të tij.

**Konkluzion:** Komisioneri vlerëson se, institucioni i kontrolluar i ka kryer procedurat e vlerësimit të rezultateve në punë sipas përcaktimeve të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, duke kryer vlerësimin sipas formatit të përcaktuar në Lidhjen nr. 1, të këtij akti nënligjor.

Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së vlerësimit, apo në përfundim të periudhës së provës, rezultojnë të jetë miratuar nga nëpunësit e ngarkuar me kompetencën e vlerësimit, të cilët në zbatim të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, kanë plotësuar në mënyrën e duhur të gjitha elementët formale të kërkuara nga formulari i vlerësimit si dhe t’i jetë njoftuar nëpunësit civil.

Një kopje e formularit standard të vlerësimit, rezultojnë të jetë depozituar në dosjen e personelit të nëpunësve civilë, për të cilët është kryer procedura e vlerësimit të rezultateve në punë.

Kujdes duhet të tregohet në drejtim të objektivitetit në vlerësim nga ana e zyrtarëve të ngarkuar me këtë detyrë, ç’ka kërkon përfshirjen në këtë proces të së gjithë spektrit të niveleve të vlerësimit nga 1 deri në 4, dhe jo vetëm dy nivelet e para, mirë dhe shumë mirë, ashtu si është konstatuar në këtë institucion. Duke vepruar në këtë mënyrë, motivohen nëpunësit dhe krijojnë bindjen se ky nuk është një proces formal por i mbështetur në arritjet personale të çdo nëpunësi civil.

## **VII. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin, si dhe rastet e tjera të transferimit).**

Gjatë procesit të verifikimit, u konstatua se, për periudhën objekt mbikëqyrje, në institucionin Bashkia Tropojë, janë zbatuar instituti i transferimit të përhershëm për shkak të shmangies së konfliktit të vazhdueshëm të interesit, i përcaktuar në nenin 52, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe instituti i transferimit të përhershëm në kuadër të

ristrukturimit të institucionit, përcaktuar në nenin 50, të ligjit të sipërcituar, të cilat paraqiten si më poshtë:

- ***Transferimi i përhershëm për shmangien e konfliktit të interesit***

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar gjatë procesit të mbikëqyrjes, vërehet **1** rast i transferimit të përhershëm, sipas nenit 49, germa "b" dhe nenit 52, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe Kreut IV, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë". Bëhet fjalë për nëpunësin:

- \*\*\*\*\* , i cili me vendimin nr. 18, datë 26.01.2017, të njësisë përgjegjëse të Bashkisë Tropojë, është transferuar nga pozicioni "Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm", në Bashkinë Tropojë (kategoria e pagës III-a/1), në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit për Mbrojtjen e Konsumatorit", në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit", në Bashkinë Tropojë (kategoria e pagës III-a/1).

Në kuptim të nenit 52, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Kreut IV, pika 30 dhe 31, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë", rezulton se, autoriteti përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesit në Bashkinë Tropojë, në rastin e nëpunësit \*\*\*\*\* , ka konstatuar konflikt të vazhdueshëm interesi në ushtrimin e detyrës në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm".

Në këto kushte, në përputhje me përcaktimet e pikës 33, të aktit nënligjor të sipërcituar, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tropojë ka vendosur transferimin e përhershëm të këtij nëpunësi, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori, brenda institucionit, konkretisht në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Mbrojtjes së Konsumatorit", sipas strukturës që ka qenë në fuqi në vitin 2017.

**Konkluzion:** Komisioneri vlerëson se, procedura e transferimit të përhershëm për shmangien e konfliktit të vazhdueshëm të interesit, në rastin e nëpunësit \*\*\*\*\* , është kryer në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

- ***Transferim për shkak të ristrukturimit të Bashkisë Tropojë (apo ndryshimit të mënyrës së organizimit të institucionit)***

Nga verifikimi i tërësisë së materialeve shkresore të vëna në dispozicion, si dhe vlerësimit të tyre në raport me ligjin vërehet se: Me urdhrin nr. 10, datë 23.01.2018, të Kryetarit të Bashkisë, "Për miratimin e strukturës organike të Bashkisë Tropojë", është miratuar struktura dhe organika e re për këtë institucion. Bazuar në këtë strukturë organizative numri i përgjithshëm i punonjësve është gjithsej 322 punonjës, nga të cilat **59** pozicione evidentohen si pjesë e shërbimit civil.

Vendimi i mësipërm ka shfuqizuar strukturën organizative të këtij institucioni, miratuar me vendimin nr. 23, datë 01.02.2017, të Kryetarit të Bashkisë, "Për miratimin e strukturës organike

të Bashkisë Tropojë”, i ndryshuar, me vendimin nr. 37, datë 08.03.2017, të Kryetarit të Bashkisë, “Për një ndryshim në strukturën organike të Bashkisë Tropojë”. Sipas kësaj strukture, konstatohet se Bashkia Tropojë së bashku me njësitë administrative ka gjithsej 291 punonjës, nga të cilat **56** pozicione vlerësohen si pjesë e shërbimit civil.

Mënyra e organizimit të pozicioneve të shërbimit civil sipas strukturës së re, krahasuar me strukturën e miratuar me vendimin paraqitet si më poshtë:

<b>Pozicionet e shërbimit civil sipas emërtesës</b>	<b>Numri i pozicioneve të punës (sipas strukturës së vjetër)</b>	<b>Numri i pozicioneve të punës (sipas strukturës së re)</b>
Sekretar i Përgjithshëm	-	-
Drejtor Drejtorie	3	4
Përgjegjës Sektori	11	11
Specialist	42	44
<b>Nëpunës civilë gjithsej</b>	<b>56</b>	<b>59</b>

Në lidhje me sa më sipër, konstatohet se, në kuadër të ristrukturimit, institucioni i Bashkisë Tropojë ka kaluar në proces ristrukturimi, për arsye se:

- Është shtuar numri i përgjithshëm i drejtorive, pasi sipas strukturës aktuale numri i drejtorive në total është **4**, ndërkohë që në strukturën e mëparshme evidentohen **3** pozicione pune të nivelit të mesëm drejtues;
- Është shtuar numri i përgjithshëm i specialistëve, pasi sipas strukturës aktuale numri i pozicioneve specialist në total është **44**, ndërkohë që në strukturën e mëparshme evidentohen **42** pozicione të nivelit ekzekutiv.
- Struktura organizative e institucionit ka pësuar riorganizim, pasi është shtuar sektori me emërtesën “*Spektori juridik dhe i prokurimeve publike*”, i përbërë nga **1** pozicion “*Përgjegjës Sektori*” dhe **2** pozicione “*Specialist*”.
- Drejtoria Ekonomike ka pësuar riorganizim, pasi sipas strukturës aktuale paraqitet me **1** pozicion “*Drejtor*”, **3** pozicione “*Përgjegjës Sektori*” dhe **9** “*Specialist*”, ndërkohë që sipas strukturës së mëparshme ka qenë e organizuar me **1** “*Drejtor*”, **2** “*Përgjegjës Sektori*” dhe **9** “*Specialist*”.
- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban ka pësuar riorganizim, pasi sipas strukturës aktuale paraqitet me **1** pozicion “*Drejtor*”, **2** pozicione “*Përgjegjës Sektori*” dhe **6** “*Specialist*”. Sipas strukturës së mëparshme, kjo njësi organizative paraqitej me **1** pozicion “*Drejtor*”, **3** pozicione “*Përgjegjës Sektori*” dhe **8** pozicione “*Specialist*”. Rezulton të jetë suprimuar njësi organizative me emërtesën “*Spektori i mbrojtjes së konsumatorit*”, me përbërje **1** pozicion “*Përgjegjës Sektori*” dhe **2** pozicione “*Specialist*”.
- Shërbimi pyjor ka pësuar riorganizim, pasi sipas strukturës së re rezulton të jetë organizuar në formën e njësisë organizative me emërtesën “*Drejtori*”, ndërkohë që sipas strukturës së mëparshme ka qenë e organizuar në nivel “*Spektori*”.

**Konkluzion:** Komisioneri arrin në përfundimin se, miratimi i strukturës së Bashkisë Tropojë me vendimin nr. 10, datë 23.01.2018, të Kryetarit të Bashkisë, “Për miratimin e strukturës organike

të *Bashkisë Tropojë*”, është shoqëruar me ristrukturim të institucionit pasi evidentohet riorganizim i strukturës organizative si dhe ndryshim të numrit total të nëpunësve të nivelit të mesëm dhe të ulët drejtues, si dhe të nivelit ekzekutiv.

- ***Procedurat e ndjekura në kuadër të ristrukturimit të Bashkisë Tropojë***

Për të verifikuar ligjshmërinë e procedurave të ndjekura nga institucioni i Bashkisë Tropojë, në kuadër të ristrukturimit, u kërkua dokumentacioni përkatës nga shqyrtimi i të cilit rezultoi se:

Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e Bashkisë Tropojë, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, ka krijuar Komisionin e Ristrukturimit, miratuar me urdhrin nr. 162, datë 29.12.2017, të Kryetarit të Bashkisë, “*Për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit në Bashkinë Tropojë*”, të përbërë nga:

- \*\*\*\*\*, me detyrë “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Turizmit, Shërbimeve Publike dhe Mbështetëse;
- \*\*\*\*\*, me detyrë “*Përgjegjës i Sektorit të emergjencave civile, transportit dhe turizmit*”, në Drejtorinë e Turizmit, Shërbimeve Publike dhe Mbështetëse;
- \*\*\*\*\*, me detyrë “*Specialist jurist*”, në Drejtorinë Ekonomike.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë procesit të mbikëqyrjes, rezulton se në momentin e procesit të ristrukturimit, kanë qenë në marrëdhënie pune **30** nëpunës civilë, por konstatohet se Komisioni i Ristrukturimit me aktin nr. 4547/1 prot., datë 29.01.2018, “*Relacion për transferimin e nëpunësve civilë në kuadrin e ristrukturimit*”, ka shqyrtuar mundësinë e transferimit vetëm për **2** (dy) nëpunës civilë, pozicionet e të cilëve rezultojnë të jenë prekur nga procesi i ristrukturimit. Bëhet fjalë për nëpunësit:

- \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit për Mbrojtjen e Konsumatorit*”, kategoria e pagës III-a/1. Nisur nga fakti, që kjo njësi organizative rezulton të jetë suprimuar me miratimin e strukturës së re, Komisioni i Ristrukturimit ka propozuar transferimin e tij në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Publike*”, kategoria e pagës III-a/1. Njësia përgjegjëse me urdhrin nr. 162/1 prot., datë 31.01.2018, ka vendosur transferimin e përhershëm të këtij nëpunësi në pozicionin e propozuar.
- \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “*Specialist për kontrollin e prodhimit ushqimor blegtoral*”, në Sektorin e Mbrojtjes së Konsumatorit, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Nisur nga fakti që ky pozicion është suprimuar me miratimin e strukturës së re, Komisioni i Ristrukturimit ka propozuar transferimin e saj në pozicionin “*Specialist për shërbimet veterinerë dhe mbrojtjen e konsumatorit*”, në Sektorin e Shërbimeve Publike, në Drejtorinë e Turizmit, Shërbimeve Publike dhe Mbështetëse.

Në zbatim të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, si dhe Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit*”, Komisioni i Ristrukturimit ka për detyrë të analizojë: a) ndryshimet strukturorë duke specifikuar pozicionet të cilat suprimohen, shkurtohen



ose riorganizohen, b) përshkrimet e punës së pozicioneve të reja të krijuara, duke evidentuar ndryshimet e kriterëve specifike si dhe c) dosjen personale të nëpunësve në pritje të transferimit, duke evidentuar elementët kyç mbi të cilët do të bazohet vendimmarrja, të cilat janë përvoja, arsimit dhe vlerësimi i arritjeve.

Në përfundim të kësaj analize, Komisioni i Ristrukturimit propozon transferimin e nëpunësve civilë në pozicionet e lira, në përputhje me strukturën aktuale të institucionit në ristrukturim. Komisioni i Ristrukturimit ka detyrimin të shprehet edhe për nëpunësit civil, pozicionet e të cilëve nuk kanë pësuar ndryshim në drejtim të kompetencave dhe funksioneve që kryejnë, por ka ndryshuar emërtesa e njësisë organizative ku ata bëjnë pjesë. Më tej, njësia përgjegjëse, pasi shqyrton aktet e Komisionit të Ristrukturimit, vijon me nxjerrjen e akteve individuale për transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë, në pozicionet e krijuara sipas strukturës së re të institucionit, duke evidentuar saktë emërtesën e pozicionit si dhe sektorin ose/dhe drejtorinë përkatëse, në të cilën raporton.

Për sa më sipër, konstatohet se, Komisioni i Ristrukturimit, nuk ka shqyrtuar mundësinë e transferimit për **27** nëpunës civil, të cilët në momentin e ristrukturimit kanë qenë në marrëdhënie punë në këtë institucion. Bëhet fjalë për nëpunësit \*\*\*\*\*. Rezulton se, Komisioni i Ristrukturimit, nuk ka shqyrtuar mundësinë e transferimit për këta nëpunës, me arsyetimin se, pozicionet e punës ku ata kanë qenë të emëruar, nuk kanë pësuar ndryshime në lidhje me kompetencat dhe funksionet e tyre, pavarësisht se në disa prej tyre evidentohen ndryshime në emërtesën e njësisë organizative, ku ato bëjnë pjesë.

Njëkohësisht, në referencë të dokumentacionit të administruar, rezulton se, për **2** nëpunës civilë, pozicionet e të cilëve rezultojnë të jenë suprimuar me miratimin e strukturës së re, Komisioni i Ristrukturimit, nuk është shprehur në lidhje me transferimin e këtyre nëpunësve. Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. \*\*\*\*\*, i cili ka qenë i emëruar në pozicionin “*Specialist i mbrojtjes së konsumatorit*”, në Sektorin e Mbrojtjes së Konsumatorit, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Aktualisht, me suprimimin e këtij pozicioni, rezulton se ky nëpunës, ushtron detyrën e tij në pozicionin “*Specialist për gjelbërimin*”, në Sektorin e Shërbimeve Publike, në Drejtorinë e Turizmit, Shërbimeve Publike dhe Mbështetëse.
2. \*\*\*\*\*, e cila ka qenë e emëruar në pozicionin “*Specialist jurist*”, pranë Drejtorisë Ekonomike. Aktualisht më riorganizimin e kësaj njësie dhe suprimimit të pozicionit të punës, rezulton se kjo nëpunëse ushtron detyrën në pozicionin “*Specialist jurist*”, në Sektorin Juridik dhe të Prokurimeve Publike.

Për punonjësit e përmendur më sipër, nuk rezulton që njësia përgjegjëse e Bashkisë Tropojë të ketë nxjerrë akte individuale për transferimin e tyre në pozicionet e reja të krijuara, sipas strukturës aktuale të këtij institucioni.

## *Konstatim*

Në observacionet e paraqitura në lidhje me këtë aspekt, njësia përgjegjëse, duke pranuar pjesërisht gjetjet e grupit të punës, pretendon se:

1. Komisioni i Ristrukturimit ka vepruar drejt duke mos marrë në shqyrtim mundësinë e transferimit të punonjësve \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*  
me pretendimin se, nuk ka asnjë ndryshim në detyrën funksionale emërtesën, pozicionin apo vartësinë e këtyre punonjësve në strukturën e vitit 2018 në raport me strukturën e 2017.

Në lidhje me këtë pretendim, Komisioneri vlerëson se në zbatim të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, Komisioni i Ristrukturimit, me miratimin e strukturës së re të institucionit, merr në shqyrtim mundësinë e transferimit të nëpunësve civilë në përputhje me pozicionet e strukturës së re.

Ky proces, qëndron në analizën krahasimore të strukturës së mëparshme me strukturën e re, në shqyrtimin e dosjeve të çdo nëpunësi civil dhe kriterëve të veçanta të pozicionit të punës dhe materializohet në relacionin arsyetues të Komisionit të Ristrukturimit, i cili i bashkëlidhet vendimit të këtij komisioni për propozimin e transferimit të nëpunësve civilë.

Në referencë të dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë mbikëqyrjes, në lidhje me procedurën e ristrukturimit të Bashkisë Tropojë, e po kështu në dokumentacionin e dërguar me observacionet tuaja, nuk vërtetohet që vendimmarrja e Komisionit të Ristrukturimit, për propozimin e transferimit të nëpunësve civile të jetë shoqëruar me praktikën përkatëse dhe relacionin arsyetues, në kushtet kur, ashtu si është analizuar edhe në projekt raport, janë konstatuar ndryshime në emërtesën dhe në organizimin e njësive të strukturës në këtë institucion. Për këtë arsye, akti i emërimit të punonjësve pas ristrukturimit, duhet të përputhet si me emërtesën e pozicionit të punës, ashtu edhe me njësinë organizative të strukturës në të cilën kryen detyrën çdo punonjës .

Për këtë arsye, në përmbajtjen e projektraportit, grupi i punës, ka arritur në konkluzionin se, Komisioni i Ristrukturimit duhet të shprehet për transferimin e punonjësve të mësipërm dhe në vijim njësia përgjegjëse, në referencë të propozimit të dhënë nga Komisioni i Ristrukturimit, të nxjerrë aktet individuale për transferimin e përhershëm të çdo nëpunësi civil, detyrë e cila do të vijojë të mbetet edhe në raportin përfundimtar.

Ky veprim i njësisë përgjegjëse do të mundësojë më tej, organizimin e burimeve njerëzore sipas strukturës përfundimtare mbi të cilën do të organizohet institucioni për vitin 2019 e në vijim.

2. Komisioni i Ristrukturimit ka vepruar drejt duke mos u shprehur për transferimin e nëpunësve \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*  
pasi emërimi i këtyre punonjësve në pozicionet

aktuale është bërë sipas procedurës së konkurrimit nëpërmjet ngritjes në detyrë, pas përfundimit të procesit të ristrukturimit.

Për këtë pretendim, Komisioneri vlerëson se, në përmbajtje të projektraportit është kërkuar që Komisioni i Ristrukturimit të shprehet për transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë, sipas pozicioneve ku ata faktikisht janë emëruar, në përfundim të kësaj procedure, konkretisht në datën **31.01.2018**.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se këto punonjëse janë emëruar në pozicionet ku ato aktualisht ushtrojnë detyrën, nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, e cila rezulton të jetë zhvilluar pas përfundimit të procedurës së ristrukturimit. Megjithatë, nuk evidentohet se në cilat pozicione të nivelit ekzekutiv janë transferuar në përfundim të procedurës së ristrukturimit, pasi nuk ekziston asnjë akt administrativ i Komisionit të Ristrukturimit dhe njësisë përgjegjëse, në lidhje me këtë veprim administrativ.

Si rrjedhim, Komisioneri vlerëson, se ky detyrim do vazhdojë të mbetet edhe në raportin përfundimtar, me qëllim që të saktësohen pozicionet në të cilat këto punonjëse kanë qenë në fazën përpara konkurrimit.

3. Komisioni i Ristrukturimit ka vepruar drejt duke mos u shprehur për transferimin e nëpunëses \*\*\*\*\*, pasi rezulton se kjo nëpunëse është emëruar “*Nëpunës civil në periudhë prove*”, pas përfundimit të procedurës së ristrukturimit.

Në referencë të dokumentacionit të administruar, pasi analizoi aktet e paraqitura nga institucioni si pjesë e observacioneve, Komisioneri e vlerëson si të drejtë pretendimin e njësisë përgjegjëse të Bashkisë Tropojë, duke mos e evidentuar në vendimin e paralajmërimit.

**Konkluzion:** Në përfundim të analizës së procedurës së ristrukturimit të institucionit, Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura e ristrukturimit të Bashkisë Tropojë nuk është kryer në përputhje me përcaktimet e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, si dhe Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit*”, pasi Komisioni i Ristrukturimit nuk ka shqyrtuar mundësinë e transferimit për të gjithë nëpunësit civilë pozicionet e të cilëve janë prekur si rrjedhojë e miratimit të strukturës së re të institucionit. Por fakti që, nëpunësit e mësipërm nuk e kanë kundërshtuar transferimin e tyre, në pozicionet ku ata aktualisht ushtrojnë detyrën, Komisioni i Ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse e Bashkisë Tropojë duhet të marrin masat si më poshtë:

1. Njësia përgjegjëse, në zbatim të pikës 18, të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit*”, si dhe nenit 144, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, duhet të kërkojë ndaj Komisionit të Ristrukturimit rishikimin

dhe ndryshimin e aktit nr. 4547/1 prot., datë 29.01.2018, “Relacion për transferimin e nëpunësve civilë në kuadrin e ristrukturimit”;

2. Komisioni i Ristrukturimit, duhet të ndryshojë aktin nr. 4547/1 prot., datë 29.01.2018, “Relacion për transferimin e nëpunësve civilë në kuadrin e ristrukturimit”, duke shqyrtuar mundësinë e transferimit për nëpunësit \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , pozicionet e të cilëve janë prekur si pasojë e ristrukturimit ose kanë ndryshuar emërtesën e njësisë ku ato raportojnë.

Në përfundim të procesit të shqyrtimit, Komisioni i Ristrukturimit, duhet të propozojë transferimin e tyre, në pozicionet e punës ku ata faktikisht kanë ushtruar detyrën në përfundim të procedurës së ristrukturimit (datë 31.01.2018)

3. Njësia përgjegjëse, duhet të finalizojë këtë proces me nxjerrjen e akteve individuale të transferimit të përhershëm për çdo nëpunës civil, duke evidentuar saktësisht në këtë akt emërtesën e pozicionit, si dhe emërtesën e njësisë organizative pjesë e të cilës janë (sektori ose/dhe drejtori), ku këta nëpunës janë transferuar në përfundim të këtij procesi (datë 31.01.2018);
4. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Tropojë, duhet të plotësojë dosjen e personelit me mendimin me shkrim të punonjësve, që janë riemëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

### **VIII. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore, kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit Disiplinor**

Instituti i disiplinës në shërbimin civil rregullohet në mënyrë të hollësishme në Kreun X, “Disiplina në shërbimin civil”, në nenet 57-61, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në këtë kapitull përcaktohen në mënyrë specifike përgjegjësia për masat disiplinore, llojet e masave disiplinore, kompetencat dhe procedura për masat disiplinore, parimet për përshkallëzimin dhe individualizmin e masës disiplinore dhe shuarja e masës disiplinore.

Në zbatim të këtyre dispozitave, në vendimin nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil” si dhe në udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët kryesore procedurale dhe materiale të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, janë përcaktuar procedurat e hollësishme dhe të gjitha masat që duhet të merren nga personat kompetentë për dhënien dhe zbatimin e tyre.

Në kuadër të drejtimeve të mbikëqyrjes, pas verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me praktikat e masave disiplinore, që janë aplikuar në institucionin e Bashkisë Tropojë, konstatohet se për periudhën objekt mbikëqyrje janë zhvilluar 9 procedime disiplinore. Duke pasur parasysh klasifikimin që i është bërë shkeljes disiplinore të pretenduar, konstatohet se:

- **8 procedura** disiplinore janë realizuar për “shkelje të rëndë”;
- **1 procedurë** disiplinore është realizuar për “shkelje shume të rëndë”.

➤ **Shkelje disiplinore e rëndë**

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, rezulton se, me vendimin nr. 136, datë 30.09.2017, të Kontrollit të Lartë të Shtetit, “Për auditimin e ushtruar në Bashkinë Tropojë dhe 7- ish komunitat: Margegaj, Tropojë fshat, Bujan, Llugaj, Fierzë, Bytyç, Lekbibaj, "Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, është kërkuar fillimi i ecurisë disiplinore, për punonjësit si më poshtë

1. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Drejtor”, i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.
2. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Pronave dhe Hartografisë”.
3. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit”.
4. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Përgjegjës i burimeve njerëzore”.
5. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Specialist i tatim taksave për realizimin e të ardhurave”.
6. \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Ndhmës Ekonomike”, në Drejtorinë Ekonomike.
7. \*\*\*\*\*, emëruar “Specialist i regjimit tatimor dhe kontrollit”, në Drejtorinë Ekonomike
8. \*\*\*\*\*, e emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit dhe Financës”.

Konstatohet se, rastet e mësipërme, janë konsideruar shkelje e rëndë disiplinore dhe në këto kushte në zbatim të pikës 2, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, procedimi disiplinor është kryer nga Komisioni i Disiplinës, i cili ka kompetencën e shkeljeve disiplinore në këtë rast.

Për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore të kryera nga nëpunësit e mësipërm, me urdhrin nr. 116, datë 16.10.2017, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, është ngritur komisioni disiplinor, përbërja e të cilit rezulton në përputhje me pikën 2, Kreu I, “Organet Disiplinore”, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen e Komisionit të Disiplinor në Shërbimin Civil”.

Komisioni Disiplinor, ka filluar ecurinë disiplinore, duke njoftuar me shkrim nëpunësit për fillimin e ecurisë disiplinore si dhe për shkakun e nisjes së kësaj ecurie, për të drejtën e tyre për të paraqitur me shkrim sqarimet rreth shkeljes së pretenduar, për të drejtën për t’u dëgjuar vetë ose me përfaqësues, si dhe datën e shqyrtimit të shkeljes së pretenduar.

Në përfundim të procedurës, Komisioni Disiplinor, duke arsyetuar shpjegimin e fakteve që janë bërë shkak për marrjen e vendimit, ka marrë vendimet individuale për të 8 nëpunësit e mësipërm, duke vendosur dhënien e masës disiplinore “*Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës deri në dy vjet*”.

➤ **Shkelje disiplinore shumë e rëndë**

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se, për periudhën e mbikëqyrjes, për 1 (një) nëpunës civil është dhënë masa disiplinore “*Lirim nga shërbimi civil*”, konkretisht:

- Punonjësi \*\*\*\*\*, i cili sipas strukturës së 2017, ka qenë i emëruar në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Publike dhe mbrojtjes e kontrollit të territorit*”. Me vendimin nr. 2, datë 01.12.2017, të Komisionit Disiplinor, është marrë masa disiplinore “*Lirim nga shërbimi civil*”.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se, Kontrolli i Lartë i Shtetit, me vendimin nr. 136, datë 30.09.2017, “*Për auditimin e ushtruar në Bashkinë Tropojë dhe 7- ish komunitat: Margegaj, Tropojë fshat, Bujan, Llugaj, Fierzë, Bytyç, Lekbibaj, "Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare"*”, ka kërkuar për nëpunësin \*\*\*\*\* fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore “*Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës deri në dy vjet*”.

Rasti i mësipërm, rezulton të jetë konsideruar shkelje e rëndë dhe për këtë arsye, në zbatim të nenit 59, pika 2, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, procedimi disiplinor është kryer nga Komisioni Disiplinor, i cili ka kompetencën për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore në këtë rast.

Në rastin e shqyrtimit të kësaj shkelje disiplinore, me urdhrin nr. 116, datë 16.10.2017, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, është ngritur Komisioni Disiplinor, përbërja e të cilit rezulton të jetë ngritur sipas përcaktimeve të pikës 2, I, “*Organet disiplinore*”, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil*”.

Gjatë shqyrtimit të shkeljeve të pretenduara ndaj nëpunësit \*\*\*\*\* , Komisioni Disiplinor, në vlerësim të provave dhe rrethanave, ka vlerësuar se shkeljet e kryera nga ky nëpunës, në zbatim të nenit 57, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, përbëjnë mospërbushje të detyrave funksionale të pozicionit, e cila klasifikohet si shkelje shumë e rëndë.

Në përfundim të procedurës, Komisioni Disiplinor, ka marrë vendimin përkatës, duke arsyetuar shpjegimin e fakteve që janë bërë shkak për marrjen e vendimit, për të cilin është vendosur dhe ndërprerja e marrëdhënies financiare për këtë punonjës.

Më tej, rezulton se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tropojë, në zbatim të nenit 58 dhe 66, pika “ë”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me vendimin nr. 144, datë 06.12.2017, ka vendosur lirim të shërbimit civil për nëpunësin \*\*\*\*\*.

**Konkluzion:** Nga sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore, që nga momenti i konstatimit të shkeljes e deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Komisioni Disiplinor, rezulton të jetë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit të posaçëm të shërbimit civil dhe të akteve nënligjore, duke siguruar një proces të rregullt të hetimit administrativ dhe ushtrimin e të drejtës së nëpunësit civil për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur gjatë një procedimi disiplinor.

Konstatohet se në tre raste punonjësit e penalizuar me masa disiplinore \*\*\*\*\*; \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* janë ankuar në gjykatën administrative.

## **IX. Administrimi i dosjeve të personelit dhe i regjistrimit të personelit**

### **a. Dojset e personelit**

Në zbatim të programit të mbikëqyrjes, u këqyrën dosjet e personelit, për të verifikuar nëse ato janë krijuar dhe administrohen në përputhje me përcaktimet e nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe kërkesave të Vendimit nr.117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrimit qendror të personelit”.

Nisur nga përmbajtja e dispozitave ligjore si më lart, në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil duhet të jenë të përfshira dokumente me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas lidhjes 1 dhe 2, bashkëlidhur aktit nënligjor, që rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt.

Më konkretisht, në dosjet personale të nëpunësve, duhet të administrohet dokumenti i identifikimit (*fotokopje e letërnjoftimit*); dokumenti mbi gjendjen civile (*certifikata e gjendjes familjare*); dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor dhe fushën e studimeve (*fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave*); dokumentet që vërtetojnë fillimin e marrëdhënieve të punës në pozicionin përkatës (*akti i emërimit*); aktet që provojnë procesin e deklarimit të statusit të punësimit; aktet që vërtetojnë gjendjen gjyqësore, apo vërtetimi i gjendjes shëndetësore (*Raporti Mjekësor*).

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, u konstatua se, në disa raste mungonte dokumenti i identifikimit, certifikata familjare, dokumenti që vërteton gjendjen gjyqësore apo vërtetimi i gjendjes shëndetësore (*Raporti Mjekësor*).

Sjellim në vëmendje të institucionit se, vërtetimi i gjendjes shëndetësore, duhet të paraqitet pranë burimeve njerëzore të institucionit, brenda datës 10 janar të çdo viti, parashikuar në pikën 23, Kreu III, “Lirimi nga shërbimi civil”, të Vendimit nr. 124, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin dhe lirim të shërbimit civil”.

Të gjitha dokumentet, duhet të pasqyrohen në fletë inventarin dhe në fletën prezantuese, të cilat përfshihen në dosjen teknike të nëpunësit, në përgjigje të kërkesave të ligjit, sikurse përcaktohet në Lidhjen 1 dhe 2 të Vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Plotësimi i këtyre kërkesave, është pasqyruar për secilin nëpunës në tabelat që i bashkëlidhen raportit, si pjesë e tij.

Nga grumbullimi i të dhënave konstatohet se, në Bashkinë Tropojë dhe në 7 njësitë administrative të këtij institucioni, në momentin e mbikëqyrjes ka gjithsej 59 pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, nga të cilat konstatohet se:

- **25** pozicione pune, duhet të konsiderohen pozicione të lira pune, nga të cilat **5** pozicione janë vakante, **1** pozicion pune është plotësuar me punonjës për të cilin duhet të vendoset përfundimi i marrëdhënies së punësimit, pasi nuk plotëson kriteret për të qenë nëpunës civil dhe **19** pozicione pune janë plotësuar me punonjës të emëruar me akte të përkohshme emërimi pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar;
- **34** pozicione pune janë plotësuar me nëpunës civil, për të cilët rezultojnë se:
  - ✓ **15** nëpunës civil janë të gjinisë mashkullore;
  - ✓ **19** nëpunës civil janë të gjinisë femërore;
  - ✓ Moshë mesatare për meshkuj është 49 vjeç
  - ✓ Moshë mesatare për femra është 49 vjeç
  - ✓ Moshë mesatare e nëpunësve civilë është 49 vjeç

Për sa i përket arsimit të nëpunësve civilë për Bashkinë Tropojë, rezultojnë të disponojnë diplomë të studimeve të larta universitare, nga të cilat:

- ✓ **32** nëpunës civilë zotërojnë diplomë të marrë nga universitetet publike të Republikës së Shqipërisë;
- ✓ **1** nëpunës civilë zotëron diplomë të marrë nga universitetet private të Republikës së Shqipërisë;
- ✓ **1** nëpunës civil zotëron diplomë të marrë jashtë vendit, të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.

### **Konkluzion:**

Për sa më sipër, duhet të merren masa që dosjet e personelit të organizohen dhe plotësohen në përputhje të plotë me përcaktimet e nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, duke



bërë pjesë të saj të gjithë dokumentacionin që është konstatuar si mangësi në Aneksin nr. 2, “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në Bashkinë Tropojë”, që është pjese e këtij raporti.

*b. Regjistri i personelit*

Regjistri i personelit është një dokument që duhet të krijohet sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Në kushtet kur, ende nuk është bërë funksional Regjistri Qendror i Personelit, që sipas ligjit administrohet nga Departamenti i Administratës Publike, në një mënyrë specifike, sipas përcaktimeve të bëra në një akt nënligjor të veçantë, rezulton se të dhënat që përmban regjistri i personelit në institucion, pasqyrojnë gjendjen reale të burimeve njerëzore në këtë subjekt.

Në këto rrethana, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tropojë, duhet të bashkëpunojë me Departamentin e Administratës Publike, për t’u përfshirë në sistemin e Regjistrimit Qendror të Personelit, duke siguruar të mundësinë për hedhjen e të dhënave të institucionit në sistem.

\*  
\*      \*

Në lidhje me pikat e programit të mbikëqyrjes, që kanë të bëjnë me institutet e ligjit, si:

- ✓ “Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj dhe si janë zbatuar kërkesat ligjore gjatë procedurës së zhvilluar në këto raste”;
- ✓ “Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të liritimit nga shërbimi civil, si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit”, gjatë procesit të mbikëqyrjes në këtë institucion, rezulton se nuk janë aplikuar procedura të tilla.

Këto ishin rrethanat e konstatuara gjatë procesit të mbikëqyrjes në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Tropojë, në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e në vijim.

Aktet administrative që dokumentojnë procesin e mbikëqyrjes në Bashkinë Tropojë, sipas pikave të këtij raporti, janë materializuar në tabelat si më poshtë:

**Aneksi nr. 1** “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar)”.

**Aneksi nr. 2** “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në datën 26.02.2014, si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil”.

Këto tabela i bashkëlidhen raportit, si pjesë e tij.

Njësia përgjegjëse dhe njësia e burimeve njerëzore e institucionit të mbikëqyrur, duhet të marrin masat për të realizuar detyrat e lëna nga Komisioneri, në vendimin e paralajmërimit, brenda afatit të vendosur në vendim, për të rregulluar situatën e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**